



PORTOFOLIO

I.Sh.P. Instituti i Shëndetit Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut



PORTOFOL

**INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË SË VERIUT**

Kujdestar i shëndetit Tuaj

Divizioni 50 nr. 6 Shkup

Tel. + 389 2 3 125 044

Fax: + 389 2 223 354

Faqja në internet: www.iph.mk,

Facebook: Институт за јавно здравје на
Република Северна Македонија

Portofol

IDENTITETI LIGJOR.....	5
PËR INSTITUTIN.....	5
HISTORIA	5
MISIONI.....	6
VIZIONI	6
VLERAT TONA.....	6
ORGANIZIMI	8
POLITIKA E CILËSISË.....	9
AKREDITIMI DHE CERTIFIKIMI.....	10
EKIPI UDHËHEQËS.....	11
VEPRIMTARIA E INSTITUTIT	12
FINANCIMI	14
PJESA E VEÇANTË	15
1. DEPARTAMENTI I PROMOVIMIT TË SHËNETIT DHE I NDJEKJES SË SËMUNDJEVE	15
2. DEPARTAMENTI STATISTIKËS SHËNETËSORE DHE I PUBLICISTIKËS	19
3. DEPARTAMENTI I EPIDEMIOLOGJISË SË SËMUNDJEVE NGJITËSE.....	23
4. DEPARTAMENTI I EKOLOGJISË SHËNETËSORE.....	27
5. DEPARTAMENTI I MIKROBIOLOGJISË.....	33
6. DEPARTAMENTI I EKZAMINIMIT DHE KONTROLLIT TË BARNAVE.....	43
7. DEPARTAMENTI I EKZAMINIMEVE KIMIKE DHE RADIOLOGJIKE	47
8. SEKTORI I PUNËVE ADMINISTRATIVE DHE I LOGJISTIKËS	57
NJË PJESË E AKTIVITETEVE TË PROJEKTEVE	61



IDENTITETI LIGJOR

Instituti i Shëndetit Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin në vazhdim ISHPRMV) është regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut nga data 2 nëntor e vitit 2009 si një Institucion Shëndetësor Publik. Organizimi, detyrat e punës, marrëdhëniet e ndërsjella dhe përgjegjësitë e të punësuarve janë të rregulluara me aktet ligjore, Statutin dhe Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.

PËR INSTITUTIN

Përfaqësimi i segmentit të shëndetit publik në vend nëpërmjet aktiviteteve të Institutit të Shëndetit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe 10 Qendrave rajonale të Shëndetit Publik, është i rëndësishëm në kuantumin e menduar dhe të zbatuar të mendimeve profesionale, monitorimet dhe kontrollet, hetimet analitike dhe vlerësimet e rreziqeve, në krijimin e veçorive nga terreni si një pasqyrë individuale deri në analizimin e tyre në tërësi si një pasqyrë e përgjithshme.

Periudha e kaluar paraqiste kurorë të aktiviteteve serioze për krijimin e një sistemi bashkëkohor të mbrojtjes shëndetësore preventive, gjegjësisht një mjeti bazë të menaxhimit duke definuar problemet prioritare dhe duke marrë vendime përkatëse në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal. Imperativ kategorik në zbatimin e strategjisë shëndetësore kombëtare dhe shëndetin publik është përmirësimi i shëndetit të popullatës në Republikën e Maqedonisë së Veriut, nëpërmjet sanimit të komponentëve të shëndetit dhe animimit të të gjithë atyre që drejtpërdrejt ose tërthorazi ndikojnë në gjendjen aktuale.

HISTORIA

Institucionalizimi i veprimtarisë preventive në rajonin e Maqedonisë së Veriut ka filluar në vitet njëzet të shekullit të kaluar. Në vitin 1921 është themeluar Stacioni i parë bakteriologjik në Shkup (Dekreti për themelimin e stacionit bakteriologjik nr. 29.964 nga viti 1920).

Dokumentet ekzistuese, ndonëse jo aq të sakta, çojnë kah konstatimi se pikërisht në maj të vitit 1924 nga stacioni bakteriologjik me laborator për ekzaminimin e sëmundjeve tropikale në Shkup nën kujdesin e Dr. Andrija Shtampar dhe me pjesëmarrjen e Fondacionit Rockefeller në Shkup është formuar Instituti për Sëmundje Tropikale, funksioni i të cilit ka qenë mbrojtja dhe përmirësimi i shëndetit të njerëzve.

Ky institucion mjekësor me karakter preventiv ka funksionuar në kushte kur tipar kryesor i patologjisë kombëtare në atë periudhë kanë qenë sëmundjet ngjitëse. Nga mesi i vitit 1927 në korrespondencën zyrtare shfaqet titulli Enti i Higjienës Shkup. Nga viti 1941 deri në vitin 1945 ka ekzistuar me emrin Instituti i Autorizuar i Higjienës në Shkup.

Nga viti 1947 Instituti i Higjienës në Shkup ka punuar me emrin Instituti kimiko -bakteriologjik nën patronatin e Ministrisë së Shëndetit Publik. Nga viti 1953 Instituti ka funksionuar si Enti Qendror i Higjienës. Nga data 15.02.1962 me aktin nr. 02-2515 institucioni është regjistruar si Enti Republikan për Mbrojtje Shëndetësore - Shkup. Me këtë emër institucioni ka funksionuar deri më 2 nëntor të vitit 2009, kur në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë është regjistruar si INSTITUCION SHËNDETËSOR PUBLIK-INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË.

MISIONI

Të promovojë shëndetin dhe mirëqenien e përgjithshme të popullatës nëpërmjet njohurive të bazuara në shkencë, praktikave të mira, informacionit dhe partneriteteve organizative dhe ndikimit në politika të qëndrueshme të shëndetit publik.

VIZIONI

Popullatë e shëndetshme në mjedis jetësor të shëndetshëm dhe të sigurt, sistem shëndetësor i qëndrueshëm dhe siguri nga kërcënimet globale dhe lokale ndaj shëndetit publik.

VLERAT TONA

Cilësia - Ne e avancojmë cilësinë duke siguruar nivelin e duhur të përsosjes në procesin e ofrimit të shërbimeve të bazuara në një nivel të lartë të njohurive, kompetencës së stafit tonë shkencor dhe profesional dhe aplikimit të metodave dhe laboratorëve të akredituar në rrafsh ndërkombëtar.

Tradita - Ne krenohemi me traditën tonë shumëvjeçare sepse ajo është rrënjësore në procesin e realizimit të aktiviteteve tona si obligim moral i punonjësve për ta arsyetuar besimin e fituar nga klientët dhe partnerët.

Efektiviteti - Në realizimin e veprimtarisë sonë ne udhëhiqemi nga arsyeshmëria e investimeve dhe mjeteve të shpenzuara nëpërmjet përdorimit të provave, fakteve shkencore dhe praktikës së mirë për arritjen e rezultateve optimale.

Partneriteti - Puna jonë është e bazuar në ndërtimin e partneriteteve dhe bashkëpunimin me partnerët tanë shumëvjeçarë në vend dhe jashtë vendit në bazë të besimit reciprok.

Përgjegjësia - Mbi bazë të parimit të drejtësisë dhe dinjitetit njerëzor, ne ndjehemi përgjegjës për të gjithë popullatën e Republikës së Maqedonisë së Veriut për shëndetin dhe mirëqenien e tyre.

PARIMET E SHËNDETIT PUBLIK

Shëndeti publik është një sistem njohurish dhe aftësish për parandalimin e sëmundjeve, zgjatjen e jetës dhe promovimin e shëndetit përmes përpjekjeve të organizuara të shoqërisë. I.Sh.P. Instituti i Shëndetit Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut si institucion kombëtar shëndetësor është vija e parë e realizimit të këtij qëllimi, të cilin e realizon nëpërmjet të sigurimit të një niveli të duhur të përsosjes në procesin e ofrimit të shërbimeve të veta, të bazuara në nivelin më të lartë të njohurive të cilat janë në dispozicion dhe të aplikueshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut, bazohet në parimet e:

1. Përgjegjësisë për shëndetin e popullatës dhe rolit udhëheqës së shtetit në ruajtjen dhe promovimin e shëndetit të popullatës;
2. Gjithpërfshirjes së masave dhe aktiviteteve me fokus tek popullata si një tërësi dhe tek grupe të caktuara sociale, si dhe tek përcaktuesit socio-ekonomikë të shëndetit dhe faktorëve më të rëndësishëm të rrezikut;
3. Bashkëpunimit midis sektorëve, një qasje multidisiplinare dhe interdisciplinare për promovimin e shëndetit – që arrihet me përmirësim të vazhdueshëm të bashkëpunimit me institucione shëndetësore të përfshira në fushën e shëndetit publik me pjesëmarrës të institucioneve të tjera në shëndetin publik;
4. Bazës shkencore dhe gjithpërfshirjes në grumbullimin e të dhënave nëpërmjet metodave kuantitative dhe kualitative – që domethënë aktivitet në shëndetin publik në bazë të metodave dhe procedurave të dëshmuara dhe provuara që përdoren me qëllim që të promovohet dhe të ruhet shëndeti i popullatës;
5. Partneritetit me popullatën dhe përforcimit të iniciativave qytetare në fushën e shëndetit publik – që realizohen për ngritjen e vetëdijes për rëndësinë e kujdesit për shëndetin personal;
6. Efkasitetit dhe efektivitetit në shëndetin publik – që realizohen me arritjen e rezultateve më të mira të mundshme në raport me burimet financiare në dispozicion, gjegjësisht arritjen e nivelin më të lartë të mundshëm me shpenzim sa më të ulët të burimeve.

ORGANIZIMI

Për ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit dhe parandalimin e sëmundjeve dhe problemeve shëndetësore të ngjashme, ISHP, si pjesë e shëndetësisë publike, për çdo ditë përballet me sfidat e zbatimit të standardeve referente botërore dhe monitorimit dhe trajnimit të vazhdueshëm për procedurat moderne analitike-diaagnostike dhe tendencat e reja shkencave të mjekësisë, shoqërore dhe humane.


Në institucionin tonë kjo është rezultat i angazhimit dhe mundit maksimal, entuziazmit, kreativitetit dhe profesionalizmit të të gjithë aktorëve dhe të gjithë profesionistëve të veprimtarisë së shëndetit publik.

Për t'i arritur qëllimet e tij, me Statut, ISHP është i organizuar në 7 departamente dhe 1 sektor me dy ose më shumë njësi dhe si subjekte të veçanta janë Këshilli shkencor dhe Menaxheri i cilësisë.

Në krye të institucionit qëndron drejtori, ndërsa puna e institucionit është nën mbikëqyrjen e Këshillit Drejtues (shiko Organogramin).

Deri më datën 30 qershor të vitit 2022 në Institutin e Shëndetit Publik janë të punësuar 202 punonjës të rregullt nga profile të ndryshme: doktorë të mjekësisë, farmacistë, stomatologë, inxhinierë të teknologjisë ushqimore, inxhinierë të kimisë, inxhinierë të maqinerisë, fizicientë, fizicientë bërthamorë, biologë, biokimistë, teknologë, infermiere, teknikë laboratorik, teknikë farmaceutikë, etj.

Në institut një pjesë e punonjësve janë profesorë, docentë, asistentë, doktorë të shkencave të shëndetit publik, doktorë shkencash në fusha shkencore mjekësore dhe jomjekësore, magjistër të shëndetit publik dhe fusha të tjera shkencore, pastaj punonjës të diplomuar me studime trevjeçare profesionale, por edhe me specializim, si dhe ekonomistë, juristë etj.





J.З.У. ИНСТИТУТ ЗА ЈАВНО ЗДРАВЈЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
I.SH.P. INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
INSTITUTE FOR PUBLIC HEALTH OF THE REPUBLIC OF NORTH MACEDONIA

POLITIKA E CILËSISË

Instituti i Shëndetit Publik i RMV-së (I.Sh.P IShP), si një institucion me përvojë shumëvjeçare në veprimtarinë shëndetësore është i përcaktuar të ruajë standarde dhe cilësi të lartë në të gjitha veprimtaritë e tij dhe ta përmirësojë në vazhdimësi reputacionin e tij. Këtë përcaktim tonin e realizojmë duke zbatuar Politikën e cilësisë, e cila na obligon për një organizim adekuat të punës, ndarje të kompetencave dhe përgjegjësi që do të sigurojnë praktikë të mirë profesionale dhe do të mundësojnë ruajtjen e standardeve të larta të cilësisë së shërbimeve në të gjitha fushat e punës. Të gjitha aktivitetet e I.Sh.P IShP zhvillohen në mënyrë të paanshme, të pavarur, objektive dhe të besueshme..

Synimi kryesor i këtij sistemi të cilësisë është përmbushja e kërkesave të rregulloreve dhe dokumenteve të tjera normative, si dhe kërkesave të shfrytëzuesve të shërbimeve, gjë që reflektohet përmes dhënies së rezultateve të sakta dhe cilësore të analizave, si dhe përmes respektimit të afateve dhe kryerjes në kohë të aktiviteteve. Të gjithë punonjësit pranë I.Sh.P IShP janë të përfshirë në sistemin e dokumentuar të menaxhimit, përdorin procedura dhe udhëzime për punë të cilat i zbatojnë me përpikmëri gjatë punës së tyre. Udhëheqësia e I.Sh.P IShP e thekson përkushtimin dhe angazhimin e saj për zhvillim, ndërsa secili nga punonjësit në pajtim me kompetencat dhe përgjegjësitë e veta kontribuon në përmirësimin e efektivitetit të punës së institucionit. Zbatimi i ISO/IEC 17025: 2017 siguron përmirësim të vazhdueshëm të sistemit të cilësisë dhe siguron një kornizë adekuate për vendosjen dhe për kontrollimin e objektivave realiste dhe të matshme të cilësisë.

Politika e cilësisë së I.Sh.P Institutit të Shëndetit Publik të RMV-së bazohet në:

- Sigurimin e një niveli të lartë të shërbimeve për klientët tanë dhe minimizimin e ankesave.
- Ekipimin me punonjës me kualifikimet e duhura duke mundësuar trajnime të vazhdueshme për punonjësit për të siguruar që ata i zotërojnë aftësitë e nevojshme për kryerjen dhe mirëmbajtjen e drejtë të aktiviteteve të punës.
- Sigurimin e paanshmërisë, besueshmërisë dhe mungesës së konfliktit të interesit. Punonjësit e përfshirë në realizimin e testeve dhe kalibrimit janë të liruar nga çdo presion i papranueshëm i brendshëm dhe i jashtëm, ndikime komerciale, financiare dhe ndikime të tjera që mund të ndikojnë negativisht në cilësinë e punës dhe vendimmarrjes së tyre. Integriteti i rezultateve të testeve është përgjegjësi e të gjithë punonjësve të angazhuar.
- Qasjen në burimet, infrastrukturën, pajisjet dhe materialet përkatëse të nevojshme për kryerjen e detyrave të caktuara.
- Zbatimin e kontrolleve efektive për monitorimin e proceseve të punës dhe identifikimin e rreziqeve dhe mundësive për përmirësim.
- Pjesëmarrjen e rregullt dhe të suksesshme në programet për krahasime ndërlaboratorike dhe testimin e aftësisë për të gjitha testimet dhe kalibrimet në fushën e akreditimit.
- Bashkëpunimin me laboratorët e ngjashëm relevant në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Shkup, 6.5.2022

DREJTOR,
Doc. d-r Shaban Memeti

POLITIKA E CILËSISË

Instituti i Shëndetit Publik i RMV-së (I.Sh.P IShP), si një institucion me përvojë shumëvjeçare në veprimtarinë shëndetësore është i përcaktuar të ruajë standarde dhe cilësi të lartë në të gjitha veprimtaritë e tij dhe ta përmirësojë në vazhdimësi reputacionin e tij. Këtë përcaktim tonin e realizojmë duke zbatuar Politikën e cilësisë, e cila na obligon për një organizim adekuat të punës, ndarje të kompetencave dhe përgjegjësi që do të sigurojnë praktikë të mirë profesionale dhe do të mundësojnë ruajtjen e standardeve të larta të cilësisë së shërbimeve në të gjitha fushat e punës. Të gjitha aktivitetet e I.Sh.P IShP zhvillohen në mënyrë të paanshme, të pavarur, objektive dhe të besueshme.

AKREDITIMI DHE CERTIFIKIMI

Duke e ditur rëndësinë e zbatimit të standardeve të cilësisë gjatë punës së tij, I.Sh.P. IShP ka kohë që ka filluar me aktivitetet për zbatimin e tyre. Laboratorët e I.Sh.P. IShP-së, që janë pjesë e Qendrës për Laboratorë Referentë, ishin ndër të parat në Maqedoni që u akredituan sipas kërkesave të standardit ISO 17025:2006. Certifikatin e parë për akreditimin e laboratorëve për testim dhe kalibrim sipas ISO 17025:2006, I.Sh.P. IShP e pranoi më 25.12.2006 nga Instituti për Akreditim i Republikës së Maqedonisë. Që atëherë I.Sh.P. IShP e përmirëson rregullisht punën e tij dhe i ndjek kërkesat e reja për sigurimin e cilësisë në punë, gjë që konfirmohet edhe nga inspektimet e rregullta vjetore nga Instituti për Akreditim në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Ekspertiza dhe kompetenca e laboratorëve konfirmohet edhe nga pjesëmarrja e rregullt e suksesshme në skemat e testimit të kapaciteteve dhe krahasimeve ndërlaboratorike brenda dhe jashtë vendit.

Qëllimi kryesor i sistemit të vendosur të cilësisë është plotësimi i kërkesave të rregulloreve dhe dokumenteve të tjera normative si dhe kërkesave të shfrytëzuesve të shërbimeve, gjë që reflektohet nëpërmjet dhënies së rezultateve të sakta dhe cilësore të ekzaminimeve, si dhe respektimit të afateve dhe kryerjen në kohë të aktiviteve. Të gjithë punonjësit e I.Sh.P. IShP-së janë të njoftuar me Politikën e cilësisë dhe janë të përfshirë në sistemin e dokumentuar të menaxhimit, përdorin procedura dhe udhëzime për punë që i zbatojnë me përpikshmëri në punën e tyre. Për funksionimin e duhur të sistemit të certifikuar të cilësisë përgjegjës është një përfaqësues i caktuar nga udhëheqësia - Menaxheri i cilësisë. Në këtë mënyrë, udhëheqësia e I.Sh.P. IShP-së thekson përkushtimin dhe angazhimin e saj për zhvillim, ndërsa çdo punonjës, në pajtim me kompetencat dhe përgjegjësitë të veta, kontribuon në përmirësimin e efektivitetit të punës së institucionit.

Instituti i Shëndetit Publik përpiket të jetë në hap me arritjet botërore në fushën e analitikës dhe në çdo moment të jetë i gatshëm për t'iu përgjigjur kërkesave dhe nevojave të shfrytëzuesve të shërbimeve dhe organeve inspektuese. Laboratorët që bëjnë pjesë në Departamentin e ekzaminimeve kimike dhe radiologjike, Departamentin e mikrobiologjisë dhe Departamentin e ekzaminimit dhe kontrollit të barnave në I.Sh.P. IShP janë të akredituar për ekzaminimin e ushqimit (cilësia dhe siguria - mikrobiologjia, pesticidet, metalet e rënda, mykotoksinat, radiologjia), ujit të pijshëm, ujit mineral dhe ujërave sipërfaqësore (cilësia dhe siguria, përmbajtja e gama-radionuklideve, aktiviteti alfa dhe beta), tokës dhe sedimenteve atmosferike, materialeve ndërtimore, barnave dhe gjëseneve për përdorim të përgjithshëm (lodra, gjësende nga plastika dhe qeramika) dhe materiale që vijnë në kontakt me ushqimin. Laboratori i kalibrimit është i akredituar për kalibrimin e instrumenteve për detektimin e rrezatimit jonizues.

Akreditimi përfshin rreth 100 metoda testimi dhe 4 metoda kalibrimi, ndërsa listën e metodave të akredituara sipas laboratorëve mund ta gjeni në uebfaqen e internetit të Institutit për Akreditim të Republikës së Maqedonisë së Veriut (LT-005 dhe LK-008).



EKIPI UDHËHEQËS

DREJTOR:

Doc. d-r. Shaban Memeti

UDHËHEQËS:

Prof. d-r. Elena Qosevska

Prof. d-r. Mihail Koçubovski

Prof. Zorica Arsova Sarafinovska

Prim. d-r. Gordana Kuzmanovska

Prim. d-r. Vjosa Reçica

Farm. dipl./spec. Katerina Starkoska

D-r. spec. Dugagjin Osmani

Ek. dipl. Julijana Tomanovska

Në Institut janë formuar edhe organe ndihmëse të Drejtorit,
të cilat nuk përfaqësojnë njësi organizative:

KËSHILLI SHKENCOR I HULUMTIMIT, I ARSIMIMIT, I MENAXHIMIT TË PROJEKTEVE, I ETIKËS, I
CILËSISË, I EUROINTEGRIMEVE, I BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR DHE I MENAXHIMIT TË
KRIZAVE

MENAXHER I CILËSISË - **D-r. ing. Maja Dimitrovska**

KËSHILLI DREJTUES

Prof. d-r Gordana Ristovska, kryetare

M-r. Zana Mustafa, anëtare

D-r. spec. Suzana Subashiq, anëtare dhe zëvendës kryetare

D-r. Elena Shishovska, anëtare

D-r. Njomza Limani Bakiji, anëtare

VEPRIMTARIA E INSTITUTIT

VEPRIMTARIA kryesore e Institutit të Shëndetit Publik është KUJDESI PËR SHËNDETIN e popullatës që realizohet nëpërmjet monitorimit, hulumtimit dhe analizimit të gjendjes shëndetësore, shkaqeve për shfaqjen dhe përhapjen e sëmundjeve ngjitëse dhe jo ngjitëse me rëndësi epidemiologjike dhe sociale-mjekësore, ndikimin tek faktorët ekologjik dhe marrjes së masave për mbrojtjen dhe përmirësimin e shëndetit të njerëzve.

Veprimtaria e IShP-së, e definuar në Ligjin për Mbrojtje Shëndetësore, Ligjin për Shëndetin Publik, Programin Vjetor Kombëtar për Shëndetin Publik dhe akte të tjera ligjore e nënligjore, realizohet përmes zbatimit të veprimtarive shkencore, profesionale dhe arsimore, gjegjësisht përmes zbatimit të 4 aktiviteteve kryesore shëndetësore:

1. veprimtaria sociale-mjekësore
2. veprimtaria epidemiologjike
3. veprimtaria sanitare-higjienike
4. veprimtaria mikrobiologjike

Gjatë veprimtarisë së tij Instituti i realizon edhe këto aktivitete:

- ★ ofron asistencë profesionale për Ministrinë e Shëndetësisë në përgatitjen e planeve dhe programeve afatmesme dhe afatgjata për shëndetin publik, në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të shëndetit, skringing-ut të popullsisë, monitorimit dhe kontrollit të sëmundjeve ngjitëse dhe jo ngjitëse;
- ★ koordinon, kontrollon dhe ndihmon me ekspertizë metodologjike në realizimin e detyrave programore preventive të Qendrave të Shëndetit Publik dhe njësive rajonale të tyre;
- ★ në bashkëpunim me institucionet tjera i zbaton dhe koordinon masat e shëndetit publik në rast të epidemive, fatkeqësive natyrore dhe krizave të tjera, emergjencave dhe fatkeqësive në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- ★ kryen studime hulumtuese-shkencore në fushën e shëndetit publik, për ta vlerësuar rezultatin dhe ndikimin e programeve preventive, me qëllim miratimin e politikave të bazuara në prova;
- ★ merr pjesë në realizimin e projekteve hulumtuese-shkencore në fushën e higjienës dhe ekologjisë shëndetësore, epidemiologjisë, mikrobiologjisë, mjekësisë sociale, gjegjësisht në fushën e veprimtarisë preventive;
- ★ realizon bashkëpunim ndërkombëtar me institucionet e ngjashme në fushën e shëndetit publik dhe siguron të dhëna shëndetësore për organizatat ndërkombëtare në përputhje me ligjin;
- ★ grumbullon, përpunon dhe analizon të dhëna për sëmundjet dhe vdekshmërinë e popullatës dhe të dhëna të tjera për gjendjen shëndetësore të popullatës, për gjendjet higjienike-epidemiologjike, për sëmundjet ngjitëse dhe jo ngjitëse, si dhe për kushte të tjera ekologjike që ndikojnë në gjendjen shëndetësore të popullatës;

- ★ propozon dhe merr pjesë në zbatimin e programeve unike për edukim shëndetësor në bashkëpunim me institucione të tjera shëndetësore, realizon aktivitete për promovimin e shëndetit dhe parandalimin e sëmundjeve;
- ★ kryen studime kombëtare dhe ndërkombëtare bihejviorale mbi stilin e jetesës së qytetarëve dhe sjelljen ndaj shëndetit;
- ★ monitoron, studion, analizon dhe evaluon situatën epidemiologjike me sëmundjet ngjitëse dhe trajton problemet aktuale lidhur me sëmundjet ngjitëse dhe gjendjet e krizës;
- ★ ndjek zbatimin e imunizimit, mbledh, përpunon dhe i analizon të dhënat mbi mbulimin e vaksinimit të popullatës dhe propozon masa për përmirësimin e gjendjes dhe mbulimin me imunizim;
- ★ përgatit dokumente strategjike, propozon dhe zbaton qëndrime doktrinare, propozon/merr pjesë në hartimin e legjislacionit dhe akteve nënligjore në lidhje me sëmundjet ngjitëse dhe imunizimin;
- ★ bën vlerësimin e rreziqeve shëndetësore-ekologjike si pasojë e ndotjes së ajrit, ushqimit, gjëseneve për përdorim të përgjithshëm, ujit të pijshëm, ujërave për larje, ujërave të zeza dhe mbetjeve të ngurta, me një theks të veçantë tek mbeturinat mjekësore dhe merr pjesë në mbikëqyrjen sanitare preventive gjatë ndërtimit të objekteve ndërtimore dhe objekteve të tjera, përdor mjete moderne softuerike për vlerësimin e rrezikut lidhur me ekologjinë shëndetësore;
- ★ ndjek, gjegjësisht zbaton masa për mbrojtjen aktive të popullatës, si dhe sëmundjet dhe gjendjet që janë pasojë e ushqimit joadekuat dhe propozon masa për eliminimin e tyre;
- ★ merr pjesë në hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore, përgatit raporte dhe mendime ekspertësh në fushën e ekologjisë shëndetësore, sigurisë ushqimore, të ushqyerit dhe mjekësisë së punës;
- ★ kryen analiza mikrobiologjike (bakteriologjike, virologjike, parazitologjike), analiza të mbetjeve të pesticideve, radiologjike, analizë të ndotësve, mykotoksinave, toksikologjike dhe biokimike dhe analiza të tjera laboratorike në kuadër të veprimtarisë së tij, monitoron rrezatimin jonizues në mjedisin jetësor dhe bën biodozimetri;
- ★ e projekton zhvillimin dhe organizon punën e sistemit informativ në fushën e shëndetësisë;
- ★ bën ekzaminimin dhe kontrollin e barnave të gatshme, substancave aktive farmaceutike dhe preparateve bimore; kontroll laboratorik dhe superanalizë të drogave narkotike dhe substancave psikotrope; ekzaminimin e lëndëve të para dhe produkteve për kozmetikë dhe produkte higjienike;
- ★ merr pjesë në veprimtarinë arsimore në nivelin e studimeve universitare, pasuniversitare dhe të doktoraturës, si dhe në specializime, nga fusha e higjienës dhe ekologjisë shëndetësore, mjekësisë së punës, epidemiologjisë dhe mjekësisë sociale; dhe bën zhvillim profesional të punonjësve shëndetësorë dhe bashkëpunëtorëve shëndetësorë nga veprimtaria preventive;
- ★ Instituti i Shëndetit Publik është bazë mësimore e Fakultetit të Mjekësisë dhe Stomatologjisë pranë Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup, ndërsa mësimdhënësit marrin pjesë në mësimdhënie edhe në universitete të tjera në vend (Universiteti “Goce Dellçev” në Shtip dhe Universiteti Shtetëror në Tetovë), si dhe jashtë vendit.

- ✧ Instituti i Shëndetit Publik, si institucion që ushtron veprimtari preventive të specializuar terciare, i koordinon detyrat që burojnë nga rregullativa ligjore në bashkëpunim me 10 Qendrat e Shëndetit Publik, Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Ministrinë e Punëve të Brendshme, institute dhe institucione të tjera shëndetësore nga shëndetësia publike dhe private, pushtetin vendor, organizata joqeveritare, biznesmenë, prodhues, shoqëri tregtare dhe subjekte të tjera që kanë lidhje me veprimtarinë që kryen ky institucion;
- ✧ veprimtaria profesionale e ISHP-së është bazë për krijimin e politikës kombëtare në fushën e shëndetit publik, duke pasur parasysh se profesionistët e punësuar në Institut janë pjesë e krijuesve të shumë akteve ligjore dhe nënligjore, strategjive kombëtare dhe planeve aksionare, programeve preventive etj., por me ekspertizën e tyre janë edhe pjesë e krijuesve të politikave ndërkombëtare shëndetësore, si persona kontakti dhe/ose bashkëpunëtorë kombëtarë me Organizatën Botërore të Shëndetësisë (OBSH), Qendrën Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve (ECDC), UNICEF-in, UNFPA-në, UNDP-në, Bankën Botërore, Këshillin e Evropës, IAEA-në, etj.;
- ✧ Instituti i Shëndetit Publik është një organizatë e cila është pjesë e shumë organizatave ndërkombëtare: IANPHI, BENA, SHE, EMCDDA, FAO, etj. Bashkëpunimi me Institutin e Shëndetit Publik është në interes të popullatës së Maqedonisë së Veriut, sepse mbrojtja shëndetësore preventive është postulat për një jetë të shëndetshme dhe të gjatë.

FINANCIMI

Financimi i aktiviteteve të Institutit sigurohet përmes realizimit të aktiviteteve programore të parashikuara në programet preventive të qeverisë, nga shërbimet për qytetarët dhe pacientët nëpërmjet veprimtarisë laboratorike në bazë të marrëveshjes me Fondin e Sigurimit Shëndetësor të RMV-së, fondeve të siguruara nga donacionet për projekte hulumtuese, fonde të tjera të cilat sigurohen nga shërbimet që Instituti i kryen për prodhuesit, importuesit dhe eksportuesit e barnave, ushqimeve, gjësendeve për përdorim të përgjithshëm, si dhe nga shërbime të tjera brenda kompetencave profesionale të punonjësve të Institutit.



PJESA E VEÇANTË

VEPRIMTARITË E DEPARTAMENTEVE TË VEÇANTA DHE SEKTORIT

A) Veprimtaria sociale-mjekësore

1. DEPARTAMENTI I PROMOVIMIT TË SHËNDETIT DHE I NDJEKJES SË SËMUNDJEVE

Udhëheqëse: Prof. d-r. Elena Qosevska

Aktivitete të Departamentit të promovimit të shëndetit dhe të ndjekjes së sëmundjeve:

- ★ planifikon, koordinon, zbaton dhe evaluon aktivitete për promovimin e shëndetit dhe parandalimin e sëmundjeve;
- ★ ndjek gjendjen shëndetësore të popullatës, sistemin e organizimit dhe financimit të mbrojtjes shëndetësore;
- ★ merr pjesë në përgatitjen dhe zbatimin e programeve të veçanta nga veprimtaria shëndetësore;
- ★ propozon masa për zgjidhjen e nevojave shëndetësore të popullatës;
- ★ përcakton prioritete për plotësimin e nevojave dhe përmirësimin e gjendjes shëndetësore të popullatës;
- ★ kryen ekspertizë profesionale për krijimin e politikave të shëndetit publik të bazuara në prova;
- ★ merr pjesë në hartimin e ligjeve kombëtare në fushën e shëndetësisë, strategjive kombëtare dhe ndërkombëtare, planeve aksionare, standardeve dhe normativave, programeve preventive të shëndetit publik, indikatorëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë për monitorimin dhe vlerësimin e gjendjes shëndetësore dhe mbrojtje shëndetësore të grupeve të cenueshme të popullatës;

- ★ realizon veprimtari publicistike duke përgatitur publikime dhe materiale shëndetësore edukative (udhëzues, pllakate, etj.);
- ★ zbaton projekte shkencore hulumtuese nga fusha e shëndetësisë;
- ★ bashkëpunon me institucione ndërkombëtare dhe kombëtare nga vendi dhe jashtë vendit;
- ★ zhvillon veprimtari mësimore dhe edukative në fushën e mjekësisë sociale dhe të shëndetit publik;
- ★ mundëson asistencë profesionale-metodologjike për organizatat shëndetësore në fushën e mjekësisë sociale, edukimit shëndetësor dhe ekonomikës në shëndetës.

Njësitë e Departamentit:

- ★ Njësia e promovimit të shëndetit dhe e menaxhimit në shëndetësi
- ★ Njësia e ndjekjes së sëmundjeve dhe e të drejtave të grupeve të cënueshme.

Njësia e promovimit të shëndetit dhe e menaxhimit në shëndetësi

- ★ zbaton veprimtari edukativo-shëndetësore nëpërmjet përpilimit të programeve specifike kombëtare dhe globale për edukim shëndetësor;
- ★ organizon dhe zbaton fushata promovuese shëndetësore, punëtori edukative, tribuna dhe manifestime të tjera;
- ★ ndjek realizimin e tyre dhe bën vlerësimin e rezultateve;
- ★ bashkëpunon me institucione ndërkombëtare për realizimin e aktiviteteve në lidhje me promovimin e shëndetit;
- ★ mundëson asistencë profesionale-metodologjike atje ku ka nevojë për një gjë të tillë;
- ★ merr pjesë në veprimtarinë edukative dhe edukimin e kuadrove shëndetësore të të gjitha profileve, nga fusha e edukimit shëndetësor;
- ★ bashkëpunon ngushtë me mjetet për informim të publikut, organizatat humanitare, shoqatat dhe asociacionet nga vendi dhe bota;
- ★ realizon veprimtari publicistike duke përgatitur publikime dhe materiale shëndetësore edukative (udhëzues, pamfleta, etj.);
- ★ zbaton projekte shkencore hulumtuese nga fusha e shëndetësisë;
- ★ përcjell dhe analizon sistemin e financimit të veprimtarisë shëndetësore dhe propozon masa për përmirësimin e tij;
- ★ bën analizë të gjendjes materiale-financiare në shëndetësi (Fondit për Sigurim Shëndetësor dhe organizatave shëndetësore);
- ★ bën analizë të shpenzimeve për mbrojtje shëndetësore në sektorin publik dhe atë privat, sipas veprimtarive;
- ★ ndjek dhe analizon koston e disa shërbimeve të veçanta shëndetësore të përcaktuara me pakon themelore të shërbimeve;
- ★ i përcjell dhe analizon indikatorët shëndetësorë për shpenzimet në shëndetësi;
- ★ bën vlerësimin e aktivitetit funksional dhe shfrytëzimit të shërbimit shëndetësor;
- ★ zgjedh, përgatit dhe analizon indikatorë demografik dhe indikator të tjerë për vlerësimin e nevojave dhe kërkesave të popullatës për lloje të caktuara të mbrojtjes shëndetësore (sipas grupeve të definuara të popullatës);
- ★ merr pjesë në avancimin e metodologjisë dhe përzgjedhjes së të dhënave për analizë ekonomike të mbrojtjes shëndetësore të popullatës;

- ★ merr pjesë në përgatitjen dhe realizimin e projekteve shkencore dhe profesionale nga fusha e organizimit, ekonomikës dhe informatikës në shëndetësi;
- ★ siguron asistencë profesionale-metodologjike për organizatat shëndetësore nga fusha e mjekësisë sociale dhe ekonomikës në shëndetësi;
- ★ realizon avancim edukativ dhe profesional të kuadrove mjekësore dhe kuadrove të tjerë të profileve të ndryshme, nga fusha e ekonomikës në shëndetësi.

Njësia e ndjekjes së sëmundjeve dhe e të drejtave të grupeve të cenushme

- ★ merr pjesë në përgatitjen dhe zbatimin e programeve të veçanta për kontrollimin e sëmundjeve jo ngjitëse;
- ★ përcakton prioritetet për plotësimin e nevojave për përmirësimin e gjendjes me sëmundjet jo ngjitëse tek popullata;
- ★ siguron të dhëna cilësore, të vlefshme dhe të azhurnuara për gjendjen me sëmundjet jo ngjitëse;
- ★ propozon masa për zgjidhjen e problemeve shëndetësore të popullatës të sëmurë nga sëmundjet jo ngjitëse kronike;
- ★ realizon veprimtari shkencor-hulumtuese për të vlerësuar rrezikun nga paraqitja e sëmundjeve jo ngjitëse në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar;
- ★ përgatit materiale edukative dhe promovuese për parandalimin e sëmundjeve jo ngjitëse tek popullata, në të gjitha mjediset për publikun e gjerë dhe në mas mediat;
- ★ realizon veprimtari publicistike përmes përgatitjes së publikimeve- informacione, raporte, analiza e të tjera dhe boton materiale shëndetësore-edukative (udhëzues, pllakate, fletushka, etj);
- ★ merr pjesë në veprimtarinë arsimore dhe edukimin e kuadrove shëndetësor të të gjitha profileve;
- ★ bashkëpunon me institucione shtetërore dhe ndërkombëtare për projekte të përbashkëta dhe aktivitete të tjera (pjesëmarrje në grupe punuese, komisione, etj.);
- ★ ndjek gjendjen shëndetësore të të gjitha grupeve të cenushme (fëmijëve, grave, adoleshentëve, të rinjve, personave me aftësi të kufizuara, emigrantëve, personave të moshuar);
- ★ propozon masa për zgjidhjen e nevojave shëndetësore të grupeve të cenushme;
- ★ realizon veprimtari shkencor-hulumtuese për të vlerësuar rrezikun nga paraqitja e sëmundjeve tek grupet e cenushme në nivel rajonal, lokal dhe kombëtar;
- ★ bën vizita në terren për vlerësim profesional-metodologjik të ekipeve preventive dhe punkteve të vaksinimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
- ★ zbaton veprimtari shëndetësore – edukative dhe edukim të familjeve në mjediset rurale dhe në komunitetin rom për shëndetin e fëmijëve, vaksinimin, shëndetin e nënave dhe adoleshentëve;
- ★ përgatit, boton dhe shpërndan udhëzues për punonjësit shëndetësor dhe doracakë për prindërit;
- ★ bashkëpunon me institucione shtetërore dhe ndërkombëtare në aktivitete e projekte (grupe punuese, komisione, etj).



2. DEPARTAMENTI STATISTIKËS SHËNDETËSORE DHE I PUBLICISTIKËS

Udhëheqëse: Prim. d-r. Vjosa Reçica

Aktivitete të Departamentit të statistikës shëndetësore dhe të publicistikës:

- ★ zbaton veprimtari shëndetësore - statistikore përmes mbledhjes, kontrollimit dhe përpunimit kompjuteristik të të dhënave shëndetësore - statistikore nga raporte shëndetësore - statistikore individuale dhe grupore;
- ★ përmes përpunimit kompjuteristik të të dhënave i mban dhe publikon regjistrat kombëtarë “Regjistrin për kancerin në Republikën e Maqedonisë së Veriut”, “Regjistrin për sëmundjen e sheqerit në Republikën e Maqedonisë së Veriut”, përgatit publikime për personat e mjekuar në mbrojtjen shëndetësore primare “Morbidityt ambulantor-poliklinik në Republikën e Maqedonisë së Veriut” dhe personat e trajtuar në stacionarët e reparteve spitalore “Morbidityt dhe mortaliteti spitalor në Republikën e Maqedonisë së Veriut”;
- ★ i evidenton me saktësi kuadrot në shëndetësi me ndihmën e një baze të mirëformuar të të dhënave;
- ★ bashkëpunon me institucione dhe organizata kombëtare dhe ndërkombëtare (si OBSH, EUROSTAD, BE, etj.) për ndjekjen dhe zbatimin e risive në veprimtarinë që ushtron;
- ★ ndjek përpunimin statistikor të raporteve për punën e organizatave shëndetësore;
- ★ merr pjesë në përgatitjen e programeve për hulumtime statistikore në fushën e shëndetësisë;
- ★ merr pjesë në përgatitjen e udhëzuesve metodologjik-profesional për zbatimin e hulumtimeve statistikore në fushën e shëndetësisë;
- ★ përgatit indikatorët shëndetësor kombëtar;
- ★ merr pjesë në përgatitjen e formularëve për dokumentacionin, evidencën dhe raportet mjekësore;
- ★ bën mbikëqyrje profesionale në fushën e statistikave shëndetësore në organizatat shëndetësore;
- ★ koordinon punën profesionale në fushën e statistikave shëndetësore në institutet për mbrojtje shëndetësore dhe shërbimet rajonale të instituteve;

- ★ merr pjesë në zhvillimin e projekteve për sistemin informativ shëndetësor në Republikë;
- ★ merr pjesë në përgatitjen e planeve operative për prezantimin e programeve aplikative;
- ★ bën analizë dhe vlerësim të të dhënave statistikore;
- ★ merr pjesë në veprimtarinë arsimore dhe kryen trajnim profesional të punonjësve shëndetësorë dhe bashkëpunëtorëve me profile të ndryshme gjatë stazhit të shërbimit dhe atij specialistik dhe lloje të tjera të përsosjes profesionale në fushën e statistikës shëndetësore;
- ★ realizon edukim dhe trajnim profesional të kuadrove mjekësore nga profile të ndryshme nga fusha e statistikës shëndetësore, informatikës në shëndetësi dhe përpunimit elektronik të të dhënave nëpërmjet kurseve dhe seminareve, si dhe inspektimeve në terren në organizatat shëndetësore me ndihmë metodologjike-profesionale dhe trajnim.

Njësitë e Departamentit:

- ★ Njësia e përpunimit statistikor të të dhënave shëndetësore dhe e menaxhimit të IT-së
- ★ Njësia e kontrollit dhe parandalimit të lëndimeve dhe të dhunës





Njësia e përpunimit statistikor të të dhënave shëndetësore dhe e menaxhimit të IT-së

- ★ përgatitje të detyrave programore dhe programeve për shfrytëzimin e bazës së të dhënave;
- ★ analizim të zgjidhjeve software-ike me qëllim përmirësimin e projektimit dhe programimit;
- ★ azhurnim dhe kompletim të dokumentacionit programor për përpunim elektronik dhe shfrytëzim optimal të të dhënave;
- ★ plotësim dhe përsosje të sistemit informatik shëndetësor (SI);
- ★ bashkëpunim me shfrytëzuesit gjatë vendosjes dhe ndërtimit të SI;
- ★ krijim të pamjes së informatave dalëse dhe përgatitjen e sistem analizave;
- ★ përgatitje të udhëzuesit për përgatitje dhe përfshirje të të dhënave nëpërmjet SI;
- ★ ndjekje dhe analizim të funksionimit të SI;
- ★ administrim dhe mirëmbajtje të sistemeve operative, bazave të të dhënave dhe zgjidhjeve aplikative software-ike që janë në përdorim në IShP;
- ★ administrim dhe mirëmbajtje të zgjidhjeve aplikative software-ike;
- ★ mirëmbajtje të rrjetit kompjuterik të IShP-së dhe të gjitha lidhjeve të tjera të komunikimit;
- ★ sigurim të arkivimit të sigurt dhe në kohë të të dhënave;
- ★ administrim dhe mirëmbajtje të sistemeve për sigurinë e të dhënave nga hyrja dhe shfrytëzimi i paautorizuar, që janë në interes të IShP-së;
- ★ administrim dhe mirëmbajtje të sistemit për mbrojtje nga viruset të sistemit informatik të IShP-së;
- ★ përkujdesje për përdorimin dhe funksionimin e drejtë të infrastrukturës së nevojshme për funksionimin e pajisjeve kompjuterike (energji, mbrojtje kundër zjarrit, aklimatizim, kontroll i lëvizjes në sallën e sistemit);

- ★ përgatitje të publikimeve, informacionit, analizave, broshurave dhe materialeve të tjera nëpërmjet in-design-it në format PDF për nevojat e Departamentit të statistikës shëndetësore dhe publicistikës, si dhe për nevojat e të gjithë departamenteve të ISHP-së së RMV-së dhe Ministrisë së Shëndetësisë të R. së Maqedonisë së Veriut;
- ★ mirëmbajtje teknike të teknologjisë kompjuterike dhe të tjera (kompjuterë, shtypës, skanerë, pajisje audio-video dhe të tjera) që përdoren në ISnP dhe mirëmbajtje të rrjetit;
- ★ kryerje të vlerësimit të materialit arkivor dhe përgatitje të regjistrit të materialit arkivor;
- ★ përpilim të planit të shenjave arkivore dhe listës së materialit arkivor me vlerë permanente;
- ★ ruajtje dhe manipulimin me shembujt arkivor sipas ligjit për material arkivor dhe akteve nënligjore;
- ★ inventarizim të materialit të dokumentuar dhe përgatitje të tij për ruajtje dhe anulim;
- ★ zbatim të masave për mbrojtjen e materialeve arkivore dhe dokumenteve nga dëmtimi fizik dhe kimik;
- ★ rregullimin sistematik të materialit arkivor me qëllim dorëzimin tek arkivi i R. së Maqedonisë së Veriut.

Njësia e kontrollit dhe parandalimit të lëndimeve dhe dhunës

- ★ e ndjek dhe studion gjendjen me lëndimet dhe dhunën në nivel lokal, kombëtar, rajonal dhe global;
- ★ i ndjek dhe i studion faktorët e rrezikut që ndikojnë në paraqitjen e lëndimeve dhe dhunës;
- ★ mirëmban regjistrat për lëndimet në pajtim me legjislacionin ekzistues dhe standardet e BE-së;
- ★ merr pjesë në dizajnimin e sistemit informativ kombëtar për mbikëqyrjen e lëndimeve, në pajtim me rekomandimet e OBSH-së;
- ★ përgatit raporte, analiza dhe mendime ekspertësh për sigurinë, gjegjësisht gjendjen me lëndimet dhe dhunën;
- ★ përgatit programe kombëtare për kontroll dhe parandalim të lëndimeve dhe dhunës;
- ★ merr pjesë në përgatitjen e strategjisë kombëtare dhe planit aksionar për kontroll dhe parandalim të lëndimeve dhe dhunës;
- ★ propozon masa adekuate për organizimin e shërbimit shëndetësor për kontroll dhe parandalim të lëndimeve: përkujdesje para-spitalore, transport të të lënduarit, përkujdesje spitalore, si dhe trajtim dhe rehabilitim të të lënduarit;
- ★ bën analizë të aspekteve sociale-mjekësore të lëndimeve dhe dhunës, si dhe analiza ekonomike të disa programeve të caktuara intervente për kontroll dhe parandalim të lëndimeve dhe dhunës;
- ★ kryen aktivitete shëndetësore edukative dhe aktivitete të tjera për promovimin e sigurisë në komunitet;
- ★ përgatit materiale edukative dhe promovuese për sigurinë e të gjitha strukturave, në të gjitha mjediset dhe nga të gjitha lëndimet, për publikun e gjerë dhe për mediat.



B) Veprimtaria epidemiologjike

3. DEPARTAMENTI I EPIDEMIOLOGJISË SË SËMUNDJEVE NGJITËSE

Udhëheqëse: Prim. d-r. spec. Gordana Kuzmanovska

Aktivitete të Departamentit të epidemiologjisë së sëmundjeve ngjitëse:

Veprimtaria epidemiologjike në Republikën e Maqedonisë së Veriut zbatohet mbi bazë të Ligjit për Shëndetin Publik, Ligjin për Mbrojtje Shëndetësore, Ligjit për Mbrojtje të Popullatës nga Sëmundjet Ngjitëse, akteve nënligjore në fuqi në këtë lëmi, si dhe mbi bazë Programeve vjetore të cilat i miraton Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në pajtim me këto rregullativa ligjore, me rekomandimet e politikës globale “Shëndet për të gjithë” dhe politikën “21 qëllime për shekullin 21” dhe vlerësimin e mëtejshëm të Programit Kombëtar për shëndetin publik në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në periudhën e ardhshme nevojitet një zvogëlim i rëndësishëm i efekteve negative të disa sëmundjeve të caktuara ngjitëse ndaj shëndetit të popullatës dhe sigurim i një kontrolli, eliminimi dhe çrënjosje e këtyre sëmundjeve.

Sa i përket angazhimeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut për integrim në Bashkimin Evropian, në periudhën në vazhdim veprimtaria epidemiologjike do vazhdojë me aktivitetet e veta për përshtatjen me rregullativën ligjore të Komunitetit Evropian.

Qëllime prioritare nga fusha e epidemiologjisë janë:

1. ruajtja e rezultateve të arrira me çrënjosjen e paralizës së fëmijëve;
2. eliminimi i tetanosit tek foshnjat e porsalindura;
3. eliminimi i fruthit dhe rubeolës autoktone dhe parandalimi i infeksionit kongjenital të rubeolës (IKR);
4. zbatimi i një monitorimi të përforcuar dhe të vazhdueshëm të imunizimit të detyrueshëm të të gjitha vajzave në moshë nga 12 vjet kundër infeksionit HPV;
5. kontrollimi i sëmundjeve të tjera kundër të cilave zbatohet imunizimi i detyrueshëm;

6. zvogëlimi i morbiditetit të lartë nga enterokolitet tek fëmijët e vegjël, nga hepatiti A viral, salmonelozat dhe sëmundjet e tjera ngjitëse të zorrëve;
7. zvogëlimi i morbiditetit nga hepatitet e tjerë viral B dhe C, për shkak të parandalimit e kancerit hepatocelular;
8. reduktimi i rrezikut nga depërtimi dhe përhapja e malaries dhe sëmundjeve të tjera që përcillen përmes vektorëve (Ethet e Nilit perëndimor, Ethet Denga);
9. zvogëlimi i rrezikut nga depërtimi dhe përhapja e kolerës dhe sëmundjeve të tjera tropikale të cilat trajtohen në karantinë;
10. zvogëlimi i incidencës nga bruceloza dhe zoonozat e tjera, parandalimi i shfaqjes epidemike të tyre;
11. parandalimi i vatrave të infeksioneve në natyrë;
12. parandalimi i HIV/SIDA-s dhe sëmundjeve të tjera të cilat përcillen përmes aktit seksual;
13. parandalimi dhe çrrënjësja e infeksioneve intrahospitale;
14. ndjekja dhe mbikëqyrja e gripit dhe sëmundjeve të ngjashme me gripin, si dhe e sëmundjeve të tjera respiratore akute;
15. parandalimi dhe çrrënjësja e sëmundjeve ngjitëse me rëndësi më të madhe epidemiologjike dhe sociale: paraqitja e rasteve të reja me sëmundje ngjitëse, rishfaqje e disa sëmundjeve ngjitëse dhe paraqitja e epidemive të sëmundjeve ngjitëse.

Në pajtim me aktet e lartpërmendura Departamenti i zbaton këto masa dhe aktivitete:

- ★ ndjekje, studim, analizë dhe vlerësim të gjendjes epidemiologjike, reagim ndaj problemeve aktuale që janë si rezultat i sëmundjeve ngjitëse në rajone të veçanta dhe në gjithë territorin e Republikës;
- ★ grumbullim, përpunim dhe analizë të raportimeve për sëmundjet ngjitëse/ shkaktarët e sëmundjeve ngjitëse dhe anketave epidemiologjike, kontrole epidemiologjike në terren dhe përgatitje të informacioneve për gjendjen në terren, rekomandim të masave për parandalim dhe për çrrënjësje të sëmundjeve ngjitëse dhe kontroll të zbatimit të tyre;
- ★ përgatitje e raporteve javore, buletineve mujore me koment epidemiologjik, raporteve dhe informacioneve periodike dhe vjetore, raporteve dhe analizave për gjendjen dhe përhapjen e sëmundjeve ngjitëse dhe masat e ndërmarra për parandalimin dhe çrrënjësin e tyre;
- ★ përgatitje e propozim programeve kombëtare në fushën e epidemiologjisë, planeve operative, protokolleve dhe udhëzuesve profesional për parandalimin edhe çrrënjësin e sëmundjeve ngjitëse;
- ★ përgatitje të planeve operativ në rast të regjistrimit të një numri më të madh të rasteve me sëmundje ngjitëse ose në rast të paraqitjes së epidemive, me aktivitete dhe masa kundër epidemike për të gjithë veprimtarinë shëndetësore;
- ★ zbatim të masave dhe aktiviteteve për parandalimin dhe çrrënjësin e infeksioneve intrahospitale;
- ★ ndjekje dhe kontroll të dezinfektimit, dezinfektimit dhe deratizimit të realizuar mbi bazë të indikacioneve profilaktike dhe epidemiologjike;
- ★ përgatitje e propozim programit vjetor për imunizimin dhe ndjekje të realizimit të këtij programi, ofrim të asistencës profesionale-metodologjike gjatë përgatitjes të planeve

operative vjetore, organizim, realizim, mbikëqyrje, si dhe vlerësim të imunizimit të detyrueshëm dhe përgatitje e raporteve për imunizimin dhe vëllimin e imunizimit të realizuar;

- ✳️ pjesëmarrje në punën e grupeve pranë Ministrisë së Shëndetësisë që kanë të bëjnë me parandalimin dhe çrënjosjen e sëmundjeve ngjitëse, si dhe me imunizimin (Komisioni për sëmundjet ngjitëse, Komisioni për gripin, Komisioni për tuberkulozin, Komiteti për imunizimin, etj);
- ✳️ bashkëpunim me institucione, organizata dhe organe ndërkombëtare të cilët e trajtojnë problematikën në fushën e sëmundjeve ngjitëse dhe imunizimit (WHO, ECDC, CDC).

Njësitë e Departamentit:

- ✳️ Njësia e parandalimit dhe e kontrollit të sëmundjeve ngjitëse
- ✳️ Njësia e imunizimit dhe e sëmundjeve të vaksinueshme-parandaluese

Njësia e parandalimit dhe e kontrollit të sëmundjeve ngjitëse

- ✳️ Ndjek dhe kontrollon sëmundjet ngjitëse në Maqedoninë e Veriut duke mbledhur, analizuar dhe përpunuar raportimet individuale për sëmundje ngjitëse, raportimet për shkaktarë mikrobiologjikë të vërtetuar të sëmundjeve ngjitëse, raportimet grupore (shtatë ditore) për gripin, si dhe informacione të shumta, njoftime dhe njohuri të tjera në lidhje me shfaqjen e sëmundjeve ngjitëse në Maqedoninë e Veriut, të cilat i merr nga Qendrat e Shëndetit Publik dhe njësitë e tyre rajonale, si dhe institucionet e tjera shëndetësore;
- ✳️ propozon, ndërmerr dhe kontrollon zbatimin e masave për parandalimin dhe çrënjosjen e sëmundjeve ngjitëse;
- ✳️ merr pjesë në hulumtimet epidemiologjike në terren në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe ofron asistencë profesionale-metodologjike;
- ✳️ përgatit raporte javore, mujore dhe vjetore për situatën me sëmundjet ngjitëse në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me koment epidemiologjik;
- ✳️ ndjek dhe kontrollon situatën me zoonozat në vend dhe koordinon aktivitetet për vënien e tyre nën kontroll, në bashkëpunim me Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, posaçërisht për brucelozën si një zoonozë e cila i nënshtrohet masave programore të veçanta të rregulluara dhe aktiviteteve për parandalim;
- ✳️ përgatit propozim Programe vjetore (për shëndetin publik, brucelozën dhe imunizimin) dhe i dorëzon ato pranë Ministrisë së Shëndetësisë;
- ✳️ përgatit raporte vjetore për realizimin e programeve preventive të lartpërmendura, raport vjetor për situatën me sëmundjet ngjitëse në vend, si dhe raporte vjetore për punën e realizuar nga Departamenti.

Njësia e imunizimit dhe e sëmundjeve të vaksinueshme-parandaluese

- ★ Ndjek dhe kontrollon realizimin e vaksinimit të detyrueshëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut (sipas kalendarit të vaksinimit), përmes kontrolleve të rregullta në terren dhe raporteve të mbulimit me vaksinim, duke siguruar asistencë profesionale-metodologjike për shërbimet e imunizimit dhe shërbimet epidemiologjike rajonale/lokale (identifikimin e mangësive dhe propozimin e masave për eliminimin e tyre, evidentim dhe raportim);
- ★ përgatit informacion periodik dhe raporte vjetore për realizimin e vaksinimit të detyrueshëm në Maqedoninë e Veriut me mbulimin e realizuar dhe propozim masa për përmirësimin e mbulimit.



C) Veprimtaria sanitare-higjienike

4. DEPARTAMENTI I EKOLOGJISË SHËNDETËSORE

Udhëheqës: Prof. d-r. Mihail Koçubovski

Aktivitete të Departamentit të ekologjisë shëndetësore:

- ★ e koordinon, kontrollon në mënyrë profesionale dhe drejton punën e veprimtarisë sanitare-higjienike në 10 Qendrat e Shëndetit Publik në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
- ★ është bartës i përgatitjes dhe zbatimit të dokumenteve strategjike dhe planeve aksionare në fushën e ekologjisë shëndetësore, sigurisë së ushqimit dhe të ushqyerit;
- ★ i koordinon aktivitetet për përgatitjen e rregulloreve kombëtare dhe harmonizimin me rregulloret ndërkombëtare lidhur me ekologjinë shëndetësore;
- ★ përgatit qëndrime doktrinare në qasjen metodologjike dhe mënyrat e vlerësimit të masave dhe të aktiviteteve të kryera në veprimtarinë sanitare-higjienike;
- ★ bazuar në hulumtimet e realizuara dhe të dhënat e fituara nga Qendrat e Shëndetit Publik, bën monitorimin dhe vlerësimin e rrezikut ekologjik-shëndetësor të disa faktorëve të caktuar në mjedisin jetësor;
- ★ departamenti merr pjesë si në segmentin programor të Institutit, ashtu edhe në procesin aplikativ dhe edukativ shkencor të specializantëve të higjienës dhe ekologjisë shëndetësore, si dhe specializantëve të tjerë që duhet të kalojnë pjesën e stazhit specialistik në Institut, gjegjësisht në Departamentin e Ekologjisë Shëndetësore, të studentëve të mjekësisë së përgjithshme, stomatologjisë, studentëve në studime profesionale trevjeçare, në studime pasuniversitare për shëndet publik dhe studime doktorature në mjekësi të përgjithshme dhe shëndet publik, si dhe në edukimin e vazhdueshëm mjekësor të mjekëve specialistë të higjienës dhe ekologjisë shëndetësore;
- ★ identifikon çështjet prioritare dhe gjendjet potenciale të rrezikut për shëndetin në nivel republikan dhe njofton Ministrinë e Shëndetësisë;

- ✧ merr pjesë në aktivitetet në kuadër të marrëveshjes dyvjeçare për bashkëpunim ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Organizatës Botërore të Shëndetësisë në fushën e ekologjisë shëndetësore;
- ✧ udhëheqës i këtij Departamenti është profesor i rregullt, specialist i higjienës.

Në kuadër të Departamentit punojnë 2 profesorë të rregullt, 1 profesor inordinar, 1 docent dhe 1 asistent, të cilët njëkohësisht janë edhe anëtarë të Katedrës së Higjienës pranë Fakultetit të Mjekësisë në Shkup, të cilët kryejnë veprimtari mësimore dhe hulumtuese për nevojat e Institutit dhe Fakultetit të Mjekësisë.

Njësitë e Departamentit:

- ✧ Njësia e sigurisë së ujit, pastrimit të mjedisit jetësor dhe e ekotoksikologjisë shëndetësore
- ✧ Njësia e sigurisë shëndetësore të ushqimit
- ✧ Njësia e ushqyerjes dhe e kontroleve shëndetësore - higjienike
- ✧ Njësia e mjekësisë së punës dhe e vlerësimit të rreziqeve shëndetësore

Njësia e sigurisë së ujit, pastrimit të mjedisit jetësor dhe e ekotoksikologjisë shëndetësore

Instituti i Shëndetit Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut e ndjek në kontinuitet gjendjen sanitare dhe higjienike në furnizimin me ujë të sigurt për pije, sigurinë e ujërave mineralë natyrorë, cilësinë higjienike të ujërave sipërfaqësore të cilat përdoren për larje dhe rekreacion dhe ujërave të zeza, cilësinë e ajrit në mjedisin jetësor në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Aktivitetet e ISHP të RMV-së janë pjesë e Programit për mbrojtje shëndetësore preventive në Republikën e Maqedonisë së Veriut (pjesa sanitare dhe higjienike). Segmenti laboratorik i këtyre aktivitetëve realizohet në laboratorët e Departamentit për ekzaminime kimike dhe radiologjike dhe pjesërisht në laboratorët e Departamentit të mikrobiologjisë pranë I.Sh.P. ISHP të RMV-së.

Laboratorët tanë janë të akredituar për ekzaminimin e sigurisë së ushqimit dhe ujit të pijshëm në pajtim me ISO 17025 (certifikati i akreditimit nr. LT – 005 nga viti 2006 dhe i riakreditimit në vitin 2022).

Në kuadër të veprimtarisë së saj, Njësia e sigurisë së ujit, pastrimit të mjedisit jetësor dhe e ekotoksikologjisë shëndetësore pranë Departamentit të ekologjisë shëndetësore në mënyrë profesionale dhe metodologjike e koordinon dhe e drejton punën e shërbimeve sanitare dhe higjienike në Qendrat e Shëndetit Publik në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut nga fusha e higjienës komunale dhe ekologjisë shëndetësore.

Njësia e sigurisë së ujit, pastrimit të mjedisit jetësor dhe e ekotoksikologjisë shëndetësore në mënyrë aktive bashkëpunon me Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor në procesin e përafrimit të legjislacionit të Republikës së Maqedonisë së Veriut me atë të BE-së.

Substrati profesional i veprimtarisë së Njesisë buron nga disa segmente të veprimtarisë së përgjithshme të Institutit.

- ✧ analiza e ndikimit të faktorëve të rrezikut nga mjedisi jetësor ndaj shëndetit të njeriut;
- ✧ mbikëqyrja dhe vlerësimi profesional i gjendjes sanitare dhe higjienike tek objektet për furnizim me ujë dhe siguria e ujit të pijshëm;
- ✧ mbikëqyrja dhe vlerësimi profesional i gjendjes me ndotjen e ujërave sipërfaqësore për larje dhe rekreacion;

- ★ elaboratet profesionale për sigurinë për sigurinë e ujërave minerale natyrore për pije dhe reparteve për ambalazhimin e ujit mineral natyror;
- ★ mbikëqyrja dhe vlerësimi profesional i gjendjes me ndotjen e ajrit në mjedisin natyror dhe ndikimi ndaj shëndetit të popullatës së ekspozuar me masa për parandalim dhe përmirësim të shëndetit të njerëzve;
- ★ elaboratet profesionale për mbrojtjen e mjedisit jetësor, të objekteve të cilat me vendndodhjen dhe teknologjinë e tyre janë ndotës potencial të saj;
- ★ mendimet profesionale për leje ekologjike të integruara A dhe B;
- ★ revizioni i elaboreve për mbrojtjen e mjedisit jetësor në funksion të vlerësimit të karakterit ekologjik-shëndetësor të vendndodhjes dhe teknologjisë, me mendim përfundimtar dhe propozim masa – me karakter lokal dhe të përgjithshëm;
- ★ kontrollet në terren, sipas nevojës marrje e mostrave adekuate dhe elaborim i një mendimi profesional për gjendjen sanitare dhe higjienike të objekteve dhe veprimtarive nga infrastruktura komunale;
- ★ elaboratet për zona sanitare të mbrojtura rreth burimeve të cilat përdoren për furnizimi publik me ujë të pijshëm dhe pikave ku merret ujë mineral natyror për ambalazhim;
- ★ inspektimi i rregullt i mënyrës së funksionimit dhe mirëmbajtjes, ndërsa me qëllim të përmirësimit të gjendjes së stacioneve të filtrimit për kondicionimin e ujërave sipërfaqësore që janë të destinuara për ujë të pijshëm;
- ★ përgatitja dhe pjesëmarrja në përpilimin e akteve ligjore dhe nënligjore nga segmenti i ekologjisë shëndetësore;
- ★ aktiviteti arsimor-shkencor dhe hulumtues me pjesëmarrje të ekipit të profesionistëve të përbërë nga profesor i rregullt, docent, mjek në specializim për higjienë dhe ekologji shëndetësore, mjek i përgjithshëm, infermiere e diplomuar dhe infermiere.

Njësia e sigurisë shëndetësore të ushqimit

Në këtë njësi realizohen këto aktivitete:

- ★ vlerësimi i sigurisë të produkteve ushqimore para se të lëshohen në qarkullim ose për kontrollim të procesit të prodhimit. Vlerësimi bëhet në bazë të analizave të bëra në laboratorët e akredituar të Institutit;
- ★ përcaktimi i vlerës nutritive (ushqyese) të produkteve ushqimore në bazë të analizave laboratorike me përdorimin e tabelave për përbërjen nutritive;
- ★ vlerësimi i rrezikut ndaj shëndetit nga ndotësit mikrobiologjik, kimik ose fizik në ushqim;
- ★ vlerësimi i ndotjes kimike të ushqimit nga prodhimtaria dhe tregu vendor, për mbetje të mykotoksinave dhe metaleve të rënda;
- ★ vlerësimi i konsumit alimantar ditor mesatar të mykotoksinave dhe metaleve të rënda tek popullata;
- ★ pjesëmarrje në hartimin e programeve dhe strategjive kombëtare, akteve ligjore dhe nënligjore, udhëzimeve metodologjike profesionale lidhur me sigurinë e ushqimit;
- ★ trajnime për njohuritë themelore për sigurinë e ushqimit dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor, të destinuara për operatorët e ushqimit, në pajtim me rregulloret ligjore pozitive. Për këtë qëllim është botuar edhe një Udhëzues për njohuritë themelore për sigurinë e ushqimit dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor.

Njësia e ushqyerjes dhe e kontrolleve shëndetësore - higjienike

- ★ Njësia e ushqyerjes dhe e kontrolleve shëndetësore higjienike ndjek dhe bën vlerësimin e ushqyerjes së popullatës në RMV, në veçanti të grupeve të cenueshme, duke përdorur metodat më të fundit dietetike për vlerësim dhe propozon masa adekuate për intervenim, në pajtim me njohuritë më të reja shkencore nga fusha e ushqyerjes dhe shëndetit publik;
- ★ i ndjek dhe vlerëson faktorët e rrezikut ndaj shëndetit që lidhen me ushqimin dhe mënyrën e jetesës;
- ★ bën vlerësim të statusit nutritiv të grupeve të popullatës me ndihmën e analizave antropometrike, laboratorike dhe funksionale, ndërsa në bashkëpunim me ekipet e Qendrave të Shëndetit Publik në RMV-së përcjell rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve dhe nxënësve në mbarë territorin e vendit tonë;
- ★ vendos udhëzime metodologjike për hulumtimet në fushën e ushqyerjes dhe shëndetit publik, për pjesëmarrje në aktivitete trajnuese për stafin specialist të degëve preventive të mjekësisë, si dhe merr pjesë në veprimtari shkencore hulumtuese dhe edukative, si dhe në zbatimin e projekteve vendase dhe ndërkombëtare;
- ★ përgatit materiale promovuese sa i përket ushqyerjes dhe stilit të jetesës të popullatës në tërësi, ose të grupeve të caktuara të popullatës;
- ★ në këtë njësi punon një ekip profesionist i përbërë nga mjekë dhe kuadro të tjera shëndetësore që është i hapur për të gjithë personat e interesuar të cilët kanë nevojë për këshilla për zvogëlimin e rreziqeve ndaj shëndetit si pasojë e ushqimit;
- ★ kontrollet shëndetësore dhe higjienike kryhen në këtë njësi me qëllim parandalimin e sëmundjeve ngjitëse të punonjësve në aktivitetet e përcaktuara me Rregulloren për mënyrën e kryerjes, përmbajtjen e kontrolleve, llojet e kontrolleve dhe afatet për kryerjen e kontrolleve të detyrueshme shëndetësore dhe higjienike të të punësuarve (Gazeta e RM-së nr. 152/2007 dhe nr. 8/2008) dhe sigurinë shëndetësore të personave që i shfrytëzojnë shërbimet e këtyre veprimtarive. Kontrollet shëndetësore dhe higjienike kryhen sipas kushteve, afateve dhe mënyrës së përcaktuar në rregulloren e lartpërmendur, ndërsa në bazë të kriterëve të përcaktuara në Ligjin për mbrojtjen e popullatës nga sëmundjet ngjitëse (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 66/2004).

Njësia e mjekësisë së punës dhe e vlerësimit të rreziqeve shëndetësore

Instituti i Shëndetit Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut është institucioni i parë shëndetësor publik i autorizuar që përmes Njesisë së mjekësisë së punës dhe vlerësimit të rreziqeve shëndetësore i realizon detyrat që burojnë nga neni 20 i Ligjit për Siguri dhe Shëndet në Punë (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 53/2013).

Pajisjet e sofistikuara dhe bashkëkohore me të cilat disponon Instituti i Shëndetit Publik, si dhe ekspertët e fushave të ndryshme në mesin e të cilëve 12 doktorë shkencash dhe 8 profesorë në fakultete të ndryshme në vend dhe jashtë vendit, mundësojnë zbatim interdisciplinar të mbrojtjes shëndetësore preventive të integruar të punonjësve. Kjo mundëson identifikim të rreziqeve fizike, kimike dhe biologjike në mjedisin e punës, si dhe përqendrimeve të tyre në materialet biologjike të punonjësve të ekspozuar gjatë punës së tyre. Në këtë mënyrë Njësia e mjekësisë së punës mund t'i realizojë në tërësi të gjitha elementet e kontrolleve mjekësore preventive, përmbajtja e të cilëve është e përcaktuar me Direktivën për llojin, mënyrën dhe vëllimin e kontrolleve shëndetësore të punonjësve (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 60/2013).

Ekipi i mjekësisë së punës të cilin e udhëheq specialist i mjekësisë së punës, e që përbëhet nga edhe një mjek specialist i mjekësisë së punës dhe një mjek në specializim për mjekësi të punës, një biokimist në specializim për gjenetikë dhe tre infermiere me arsim të lartë të trajnuara për monitorim biologjik, në bashkëpunim me ekspertët e laboratorëve të tjerë (të biokimisë, mikrobiologjisë, toksikologjisë dhe radiologjisë) mundëson mbikëqyrje të gjendjes shëndetësore të punonjësve të ekspozuar ndaj:

- ★ rrezatimit jonizues dhe jo jonizues me monitorim të dozimetrisë individuale/personale;
- ★ rreziqeve biologjike në mjedisin e punës me përcaktim të markerëve të infeksionit në materialet biologjike (gjak, urinë, serum, etj.);
- ★ rreziqet kimike në mjedisin e punës me përcaktim të markerëve biologjik të ekspozimit në materialet biologjike (metale të rënda, përbërje organike - hidrokarbure ciklike dhe aciklike dhe derivatet amino dhe nitro halogjene të tyre).

Pikërisht për këto arsye, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut e caktoi Institutin e Shëndetit Publik që nëpërmjet Njesisë së mjekësisë së punës të shërbejë si laborator për nevojat e institucioneve të tjera të autorizuar për siguri dhe shëndet në punë, e ku ata do mund të dërgojnë mostrat e tyre për të gjitha këto lloje të analizave për realizimin e të cilave nevojiten pajisje të sofistikuara dhe aparatura të kushtueshme me të cilat ata nuk disponojnë (plazmë induktive ICP-MS përmes spektrometrisë së masës, spektrofotometri apsorbuuese atomike: me teknikë me flakë, me kivetë grafiti dhe me sistem hidrid, kromatografi e lëngët, kromatografi me gaz, kromatografi infra e kuqe, dozimetri termolumineshente për rrezatimin jonizues, diagnostikim i plotë bakteriologjik, virologjik dhe parazitologjik për të gjitha sëmundjet ngjitëse profesionale dhe përcaktim i markerëve të ekspozimit).

Instituti i Shëndetit Publik nëpërmjet Njesisë së mjekësisë së punës nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut është autorizuar si Qendër trajnimi për shëndetin profesional përgjegjës për organizimin e trajnimeve si bazë për licencimin e profesionistëve të cilët veprojnë në këtë fushë.

Instituti i Shëndetit Publik nëpërmjet Njesisë së mjekësisë së punës bën edhe analizë të lëndimeve në vendin e punës në Republikën e Maqedonisë së Veriut, i grumbullon dhe i përpunon të dhënat për punën e realizuar nga institucionet përgjegjëse për shëndetin në punë, mirëmban regjistrin për sëmundjet profesionale dhe aktivitete të tjera të domosdoshme për mbikëqyrjen e gjendjes në këtë fushë. Bashkëpunon me Entin Shtetëror të Statistikave për mbledhjen e integruar të të dhënave dhe menaxhimin e regjistrave të lartpërmendur.



D) Veprimtaria mikrobiologjike

5. DEPARTAMENTI I MIKROBIOLOGJISË

Udhëheqës: D-r. spec. Dugagjin Osmani

Aktivitete të Departamentit të mikrobiologjisë:

- ✧ ekzaminime mikrobiologjike të shkaktarëve të sëmundjeve ngjitëse, identifikimi i tyre dhe ofrimi i mendimeve specialistike - konsultative;
- ✧ ndjekje të ndjeshmërinë antimikrobike dhe rezistencat më të shpeshta ndaj barnave antimikrobike antimikrobike të llojeve bakteriale invazive në të gjithë territorin e vendit përmes rrjetit CAESAR;
- ✧ ndjekje mikrobiologjike të sëmundjeve ngjitëse me interes për shëndetin publik të popullatës në R. e Maqedonisë së Veriut në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e Popullatës nga Sëmundjet Ngjitëse dhe rregulloret tjera ligjore;
- ✧ pjesëmarrje në hetimin mikrobiologjik të epidemive/pandemive të agjensëve mikrobiologjikë përmes identifikimit të burimeve të infeksionit, bartësve të mikrobeve dhe rrugëve të transmetimit; diagnostikim molekular të agjensëve infektivë (mikrobiologji molekulare), detektim i gjeneve për rezistencën tek mikroorganizmat me rezistencë ndaj një ose më shumë grupeve të antibiotikëve; studim të seroprevalencës tek popullata për sëmundje të veçanta ngjitëse;
- ✧ shërben si laborator kombëtar për diagnostikimin dhe monitorimin e gripit, HIV, fruthit, rubeolës, infeksioneve arbovirus (virusi i Nilit Perëndimor, Zika dhe të tjerë), viruset e etheve hemorragjike (virusi Hantaan dhe të tjerë) dhe sëmundje të tjera me rëndësi për shëndetin publik, ndërsa në përputhje me Rregulloren Ndërkombëtare të Shëndetit (2005) dhe nevojat e R. së Maqedonisë së Veriut;
- ✧ jep asistencë profesionale metodologjike për Ministrinë e Shëndetësisë nga fusha e mikrobiologjisë;
- ✧ bën tipizimin e shkaktarëve;

- ★ kryen ekzaminime entomologjike mjekësore dhe hartëzimin e vektorëve për sëmundjet endemike që transmetohen nga vektorët në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
- ★ kryen kontroll laboratorik të masave të ndërmarra (sterilizim, imunizim);
- ★ kryen diagnostikim mikrobiologjik, ekzaminime shëndetësore dhe të tjera të detyrueshme të parapara me Ligjin për Mbrojtjen e Popullatës nga Sëmundjet Ngjitëse dhe rregulloret e tjera ligjore;
- ★ kryen ekzaminime mikrobiologjike të ujit, produkteve ushqimore, ushqimit, mjediseve dhe pajisjeve për prodhimin, përpunimin dhe distribuimin e produkteve ushqimore me vlerësim të rregullshmërisë mikrobiologjike sipas rregullores për ushqimin;
- ★ kryen kontroll mikrobiologjik në organizatat shëndetësore (salla për operim, salla për reanimim, etj. mjedise, instrumente, materiale etj.);
- ★ koordinon punën dhe ofron asistencë profesionale metodologjike për Qendrat e Shëndetit Publik në fushën e mikrobiologjisë;
- ★ përcakton dhe zbaton kritere doktrinare profesionale metodologjike nga fusha e mikrobiologjisë;
- ★ përmes bashkëpunimit me institucionet arsimore në R. e Maqedonisë së Veriut merr pjesë në aktivitetin edukativo-arsimor dhe zbaton avancim profesional të punonjësve dhe bashkëpunëtorëve shëndetësorë në fushën e mikrobiologjisë;
- ★ merr pjesë në realizimin e projekteve hulumtuese-shkencore në fushën e mikrobiologjisë.
- ★ kryen ekzaminime laboratorike të ujit të pijshëm, sipërfaqësor dhe ujërave të zeza në punimet hulumtuese studimore, monitoron ndotjen e ujërave dhe rrjedhave ujore ndërshtetërore, kryen mbikëqyrje sanitare të vazhdueshme të ujit të pijshëm;
- ★ bën testin për endotoksinën bakteriale (testi LAL) sipas Farmakopesë Evropiane (Ph. Eur 2.6.14) për testimin e barnave parenterale, preparateve për irigacion, ujit për hemodializë, tretjeve për hemodializë;
- ★ bën vlerësim profesional të dokumentacionit për kontrollin e cilësisë dhe vlerësimin e paketimit të një serie të importuar të barnave biologjike /vaksinave;
- ★ bën testimin e sterilitetit dhe pastërtisë mikrobiologjike të lëndëve të para për barna dhe barna të gatshme, produkteve mjekësore bimore dhe ekstrakteve;
- ★ bën testimin e lëndëve të para për barna dhe barna të gatshme në aspektin e pastërtisë mikrobiologjike dhe sterilitetit në përputhje me kërkesat e Farmakopesë Evropiane;
- ★ bën testimin e preparateve kozmetike për nga cilësia mikrobiologjike;
- ★ teston efikasitetin antimikrobik të dezinfektuesve;
- ★ bashkëpunon me laboratorët referentë ndërkombëtare në fushën e mikrobiologjisë dhe merr pjesë në rrjetet ndërkombëtare për monitorimin dhe diagnostikimin e agjensëve mikrobiologjikë me interes për shëndetin publik;
- ★ ka një bashkëpunim të suksesshëm me autoritetet ndërkombëtare shëndetësore si OBSH, ECDC dhe të tjera;
- ★ Departamenti i mikrobiologjisë në vazhdimësi do të angazhohet për ndjekjen dhe prezantimin e metodave të reja mikrobiologjike në hap me zhvillimet më të fundit në fushën e mikrobiologjisë, bazuar në mjekësinë e bazuar në prova.

Departamenti përbëhet nga këto Njësi:

1. Njësia e virologjisë
2. Njësia e bakterologjisë
3. Njësia e kontrollit mikrobiologjik të ushqimit dhe barnave
4. Njësia e parazitologjisë

Njësia e virologjisë

Njësia e virologjisë dhe e diagnostikimit molekular është e vetmja e këtij lloji në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Ajo për herë të parë u themelua në vitin 1960 me qëllim: ndjekjen, studimin dhe diagnostikimin laboratorik të sëmundjeve virale.

Për ta bërë këtë aplikohen metodat më moderne të diagnostikimit serologjik (imunoenzima dhe imunoblot) dhe molekular, si dhe izolimi i viruseve në kulturat qelizore, me ç'rast ndiqet literatura botërore dhe rekomandimet e OBSH-së.

Nga viti 2005 kjo Njësi nga OBSH është akredituar si Laborator kombëtar për morbilin dhe rubeolën në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Nga viti 2006 Laboratori për HIV-in është caktuar si Laboratori referent për HIV/AIDS në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në kuadër të së cilit ekziston edhe një këshillimore për testime dhe këshillime falas.

Laboratori për gripin nga Ministria e Shëndetësisë është nominuar për Qendër Kombëtare të Influcencës dhe është i përfshirë në Programin e OBSH-së për Vlerësimin ekstern të cilësisë për zbulimin e viruseve të influencës.

Në këtë Njësi më 17 janar të vitit 2020 për herë të parë në vend u prezantua diagnostikimi i SARS-CoV-2 (Novel corona virus 2019-nCoV).

Kjo Njësi është e vetmja në vendin tonë të cilën OBSH e ka angazhuar në procesin e ruajtjes së statusit të një vendi pa poliomielit.

Analizat që kryhen në këtë laborator:

Detektimi i ARN/ADN me RT PCR të këtyre viruseve:

- | | |
|--|---------------------------------------|
| - <i>Human Adeno virus A/B</i> | - <i>Respiratory Syncytial virus</i> |
| - <i>Coronavirus 229E</i> | - <i>Morbili virus</i> |
| - <i>Coronavirus HKU1</i> | - <i>Rubeolla virus</i> |
| - <i>Coronavirus NL63</i> | - <i>West Nile virus</i> |
| - <i>Coronavirus OC43</i> | - <i>Denga virus</i> |
| - <i>MERC- CoV</i> | - <i>CHIKU virus</i> |
| - <i>SARS -CoV-2</i> | - <i>Zika virus</i> |
| - <i>Human Metapneumo virus</i> | - <i>CMV</i> |
| - <i>Human Rhinovirus/Entero virus</i> | - <i>Epstein Bar virus</i> |
| - <i>Influenza A</i> | - <i>Human Herpes virus 6</i> |
| - <i>Imfluenza B</i> | - <i>Varicela Zoster virus</i> |
| - <i>Parainfluenza virus1</i> | - <i>Human Herpes virus 1</i> |
| - <i>Parainfluenza virus2</i> | - <i>Human Herpes virus 2</i> |
| - <i>Parainfluenza virus3</i> | - <i>Human monkeyopx virus (MPXV)</i> |
| - <i>Parainfluenza virus4</i> | |

- ★ subtipizimi i viruseve të gripit *Influenza A* dhe *B*;
- ★ zbulimi dhe karakterizimi i varianteve VOC dhe VOI, të virusit *SARS-CoV-2*.

Nga muaji janar i vitit 2021 bëhet sekuencionimi i të gjithë gjenomit të virusit SARS-CoV-2, si dhe i viruseve të tjera nga paneli respirator.

Nga muaji korrik i vitit 2022 bëhet zbulimi i MPXV si dhe sekuencionimi i gjenomit të Monkeypox virus.

Detektimi i antigjeneve dhe antittrupave të viruseve me:

- ★ ELISA – Testi imuno-enzimatik
- ★ ELFA – Testi imuno-enzimatik fluoeshent
- ★ IEHT – Testi imuno-enzimatik hemilumineshent
- ★ IHT – Testi imuno – kromatik
- ★ WB - Western blot test
 - *Cytomegalo virus (CMV)* IgM gjak
 - *Cytomegalo virus (CMV)* IgG gjak
 - *Cytomegalo virus (CMV)* IgGA vidity-përcaktimi i vjetërsisë së antitrupave gjak
 - *HAV* IgM antitrupa gjak
 - *HAV* total antitrupa gjak
 - *HBs* antigen gjak
 - *HBs* total antitrupa gjak
 - *HBc* total antitrupa gjak
 - *HBc* IgM antitrupa gjak
 - *HBe* antigen gjak
 - *HBe* total antitrupa gjak
 - *HCV* antitrupa gjak
 - *HCV* RNA – kuantitativ gjak
 - *HIV* 1/2 antitrupa gjak
 - *HIV* integral (Ag +At) gjak
 - *HIV* duo (P24 Ag +At) gjak
 - *Herpes simplex virus (HSV2)* IgM antitrupa gjak
 - *Herpes simplex virus (HSV2)* IgG antitrupa gjak
 - *Herpes simplex virus (HSV1)* IgM antitrupa gjak
 - *Herpes simplex virus (HSV1)* IgG antitrupa gjak
 - *Herpes zoster virus – Varicela (VZV)* IgM antitrupa gjak
 - *Herpes zoster virus – Varicela (VZV)* IgG antitrupa gjak
 - *Morbilli* IgM antitrupa gjak
 - *Morbilli* IgG antitrupa gjak
 - *Mumps* (parotitis) IgM antitrupa gjak
 - *Mumps* (parotitis) IgG antitrupa gjak
 - *Rubeolla* IgM antitrupa gjak
 - *Rubeolla* IgG antitrupa gjak
 - *West-Nile virus* IgM antitrupa gjak
 - *West-Nile virus* IgG antitrupa gjak
 - *Hantaan virus* IgM antitrupa gjak

- Hantaan virus IgG antitrupe	gjak
- TBE virus IgM antitrupe	gjak
- TBE virus IgG antitrupe	gjak
- Congo Crimean Haemorrhagic Fever virus IgM antitrupe	gjak
- Congo Crimean Haemorrhagic Fever virus IgG antitrupe	gjak
- Parvovirus B19 IgM antitrupe	gjak
- Parvovirus B19 IgG antitrupe	gjak
- Entero virusi (Rota, Noro, Astro, Adeno)	feces

Në këtë Njësi bëhen edhe testime të imunoenzimave për vërtetimin e antitropave ndaj këtyre mikroorganizmave:

- <i>Borrelia burgdorferi</i> (Lyme boreliosis) IgM antitrupe	gjak
- <i>Borrelia burgdorferi</i> (Lyme boreliosis) IgG antitrupe	gjak
- <i>Toxoplasma gondii</i> IgM antitrupe	gjak
- <i>Toxoplasma gondii</i> IgG antitrupe	gjak
- <i>Toxoplasma gondii</i> IgG Avidity—одредување старост на Антитела	gjak
- <i>Q</i> treska phase 1/2 IgM antitrupe	gjak
- <i>Q</i> treska phase 1/2 IgG antitrupe	gjak
- <i>Helicobacter pylori</i> IgG antitrupe	gjak

Njësia e bakterologjisë

Në Njësinë e bakterologjisë bëhet diagnostikimi bakterologjik i materialeve kryhet sipas indikacioneve klinike dhe epidemiologjike. Bëhet kontroll mikrobiologjik i mjedisit jo të gjallë: rregullshmëria mikrobiologjike e ajrit, rregullshmëria mikrobiologjike e sterilizimit të thatë dhe të lagësht me indikatorë biologjikë dhe rregullshmëria mikrobiologjike e mjedisit jo të gjallë - objekteve dhe sipërfaqeve.

Një kujde i veçantë i kushtohet regjistrimit dhe monitorimit të rezistencës së llojeve bakteriale ndaj mjeteve antimikrobike.

Në laborator bëhen edhe analiza bakterologjike për praninë e baktereve te personat të cilët i nënshtrohen ekzaminimeve sanitare në pajtim me Ligjin për Mbrojtje Shëndetësore në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Shërbime bakterologjike:

- ★ Analizë bakterologjike e strishos nga hunda
- ★ Analizë bakterologjike e strishos nga fyti
- ★ Analizë bakterologjike e strishos nga zgavra e gojës (gingiva, afte, gjuhë)
- ★ Analizë bakterologjike e përshtymës
- ★ Analizë bakterologjike e bronholavitit – aerobe
- ★ Analizë bakterologjike e ndryshimeve në lëkurë
- ★ Analizë bakterologjike e strishos nga sytë (konjuktivi)
- ★ Analizë bakterologjike e strishos nga veshi i jashtëm
- ★ Analizë bakterologjike e strishos nga veshi i mesëm – aerobe
- ★ Analizë bakterologjike e strishos nga veshi i mesëm – anaerobe
- ★ Analizë bakterologjike e strishos nga kërthiza
- ★ Analizë bakterologjike e strishos nga plaga, djegia, fistulla – aerobe

- ★ Analizë bakterologjike e strishos nga plaga, djegia, fistulla -anaerobe
 - ★ Analizë bakterologjike e strishos nga braunilla, kanilla, tubuesi, katetra, dreni –aerobe
 - ★ Analizë bakterologjike e strishos nga braunilla, kanilla, tubuesi, katetra, dreni –anaerobe
 - ★ Analizë bakterologjike e punktosit, abcesit, eskudatit – aerobe
 - ★ Analizë bakterologjike e punktosit, abcesit, eskudatit – anaerobe
 - ★ Analizë bakterologjike e dializatit – aerobe
 - ★ Analizë bakterologjike e dializatit – anaerobe
 - ★ Hemokulturë – aerobe
 - ★ Hemokulturë – anaerobe
 - ★ Analizë bakterologjike e urinës
 - ★ Analizë bakterologjike e strishos nga uretra
 - ★ Analizë bakterologjike e strishos nga uretra për mykoplazma (Mycoplasma hominis dhe Ureoplasma ureoliticum)
 - ★ Analizë bakterologjike e strishos nga vulva
 - ★ Analizë bakterologjike e strishos nga vagjina dhe kanali cervikal
 - ★ Analizë bakterologjike e strishos nga vagjina dhe kanali cervikal për mykoplazma (Mycoplasma hominis i Ureoplasma ureoliticum)
 - ★ Analizë bakterologjike e spermës (spermokulturë) – aerobe
 - ★ Analizë bakterologjike e spermës (spermokulturë) – anaerobe
 - ★ Analizë bakterologjike e fecesit (koprokulturë)
 - ★ Analizë bakterologjike e strishos rektale
 - ★ Serotipizim i baktereve të llojit Salmonella dhe Shigella
 - ★ TPHA – Treponema pallidum– antitrupe specifike antitreponemike
 - ★ RPR – Treponema pallidum – antitrupe jo specifike antitreponemike
 - ★ Francisella tularensis – slajd testi i aglutinimit
5. Francisella tularensis – Reaksioni zinxhir i polimerazës në kohë reale për detektimin e acideve nukleike
- ★ Reaksioni zinxhir i polimerazës në kohë reale për detektimin e Bordetella pertusis
 - ★ Reaksioni zinxhir i polimerazës në kohë reale për detektimin e Legionella pneumophila
 - ★ Reaksioni zinxhir i polimerazës në kohë reale për detektimin e Treponema pallidum
 - ★ Reaksioni zinxhir i polimerazës në kohë reale për detektimin e Neisseria gonorrhoeae
 - ★ Analizë e ndjeshmërisë së mikroorganizmave të izoluar ndaj antibiotikëve dhe kimioterapeutikëve (antibiogram)
 - ★ PVR Multiplex për zbulimin e rezistencës së gjeneve ndaj preparateve të caktuara antimikrobike.

Njësia e kontrollit mikrobiologjik të ushqimit dhe barnave

- *Laboratori për kontroll mikrobiologjik të ushqimit dhe ujit*

Në punën e tij laboratorit e ka implementuar sistemin e cilësisë - MKC EN ISO 17025:2018, dhe si pjesë e programeve dhe aktiviteteve rutinore parashih kryerjen e këtyre analizave:

- ★ Kontroll mikrobiologjik të ajrit, strishove nga sipërfaqet punuese dhe duart e punonjësve në industrinë ushqimore;
- ★ Kontroll mikrobiologjik të gjëseneve për përdorim të përgjithshëm;

- ★ Laboratori për ekzaminimin e barnave – pastërtinë e barnave të gatshme dhe pajisjeve ndihmëse mjekësore të cilat janë të deklaruara si sterile (Ph. Eur. 2.6.1);
- ★ Pastërtinë mikrobiologjike të lëndëve të para për prodhimin e barnave, formave të gatshme farmaceutike, paketimit primar (Ph.Eur 5.1.4);
- ★ Pastërtinë mikrobiologjike të produkteve mjekësore bimore dhe ekstrakteve (Ph.Eur 5.1.8);
- ★ Pastërtinë mikrobiologjike të produkteve kozmetike (G. Zyrtare 94/2010).

Nga muaji maj i vitit 2008 laboratori është i akredituar me ISO 17025 dhe punon në pajtim me rregullativën ligjore për ekzaminimin e rregullshmërisë mikrobiologjike të ushqimit “Rregullorja për kërkesat e veçanta për sigurinë e ushqimit në raport me kriteret mikrobiologjike” (G. Zyrtare e RM-së 100/2013; 229/2020).

Në laborator punohen këto parametra:

1. Vërtetim dhe identifikim i *Salmonella* (ISO 6579 : 2017);
2. Vërtetim i koagullazës pozitive për *Staphylococcae* (ISO 6888-1: 2008);
3. Numërim i *Clostridii* sulfido-reduktuese (ISO 15213:2003);
4. Numërim i *Clostridium perfringer* (ISO 7937: 2004);
5. Numërim i beta glukoronidasa pozitiv *E. coli* (ISO 1664 –2: 2017);
6. Vërtetim i *E. Coli* 0157:H7 (ISO 16654 : 2001);
7. Vërtetim i *Listeria monocytogenes* (ISO 11290-2: 2018);
8. Vërtetim i *Campilobacter spp* (ISO 10272 - 1: 2017);
9. Vërtetim i *Yersinia enterocolitica* (ISO 10273 - 2017);
10. Vërtetim i *Bacillus cereus* (ISO 7932: 2020);
11. Vërtetim i *Enterobacteriaceae* (ISO 21528-2: 2017);
12. Vërtetim i *Cronobacter sakazakii* (ISO/TS 22964: 2017);
13. Vërtetim i *Vibrio parahemoliticus* (ISO 8914: 2007);
14. Vërtetim i *Lactobacilli*;
15. Vërtetim i llojeve të *Streptococcus*;
16. Numërimi i numrit të përgjithshëm të bakteve mezofile aerobe (ISO 4833: 2013);
17. Numërimi i tharëve dhe myshqeve (ISO 21527-1,2: 2008);
18. Vërtetim i VIDAS *Salmonella* (SPT) metoda ELFA (certifikat AFNOR);
19. Vërtetim i VIDAS *L.monocytogenes Xpres* (LMX) metoda ELFA (certifikat AFNOR);
20. Vërtetim i VIDAS *E.coli* 157:H7 (ECPT) metoda ELFA (certifikat AFNOR);
21. Vërtetim i VIDAS *Campylobacter* (CAM) metoda ELFA (certifikat AFNOR);
22. Vërtetim i VIDAS *Staph enterotoxin* (SET2) metoda ELFA (certifikat AOAC).

Ekzaminimi i sigurisë mikrobiologjike të ujit bëhet në përputhje me “Rregulloren për sigurinë e ujit, mineral, të burimeve dhe ujërave të tjerë” (G. Zyrtare e RM-së 46/2008; 129/2014 dhe 183,184/2018).

Në laborator punohen këto parametra:

23. Përcaktimi i MNP i organizmave koliforme dhe i TT *E. Coli* (ISO 9308-2:2016);
24. *E.coli* dhe bakteret koliforme me MF (ISO 9308 -1 : 2017);

25. Numri i përgjithshëm i baktereve aerobe në 22°C në 1 ml (ISO 6222 : 1999);
26. Numri i përgjithshëm i baktereve aerobe në 37°C në 1 ml (ISO 6222 : 1999);
27. Përcaktimi i pranisë së *Enterococcus* në ujë MF (ISO 7899 – 2 : 2000);
28. Përcaktimi i pranisë së *Legionella pneumophila* MF (ISO 11731 – 1,2 : 2018);
29. Përcaktimi i pranisë së *Pseudomonas aeruginosa* MF (ISO 16266 : 2006);
30. Përcaktimi i numrit të *Clostridium perfringens* me MF (ISO 14189 : 2017);
31. Zbulimi dhe numërim i *Clostridium sulfido reduktuese*(ISO 26461 – 2 : 2017);
32. Përcaktimi i pranisë së llojeve *Proteus, Salmonella, Shigella* etj.

- *Laboratori për kontrollin mikrobiologjik të barnave, sterilitetit dhe preparateve kozmetike*

- ✧ Ekzaminimi i sterilitetit të barnave duke përdorur metodën e filtrimit membranor dhe mbjelljes direkte, ku bëjnë pjesë preparatet për aplikim parenteral dhe produktet e tjera mjekësore që deklarohen si sterile, si pikat e syve, pajisjet ndihmëse mjekësore, etj.;
- ✧ ekzaminimi i pastërtisë bakteriologjike të të gjitha formave të dozuarat me aplikim oral, lokal ose rektal, përfshirë këtu tabletat, kapsulat, supozitorët, kremrat, pomadat, vagjinaletet, si dhe preparate të tjera që mund të jenë me origjinë sintetike ose me origjinë organike (bimore, minerale ose shtazore) me metodën e mbjelljes së drejtpërdrejtë në një mostër të përgatitur në mënyrën adekuate ose me metodën e filtrimit membranor;
- ✧ ekzaminimi i pastërtisë bakteriologjike të ujit për përdorim farmaceutik me metodën e filtrimit membranor;
- ✧ ekzaminimi i pastërtisë bakteriologjike të ambalazheve primare si kapsulat, folitë Al, folitë PVC, shishet e qelqit, shishet e plastikës, flakonët, pikatoret, alveolat për supozitorët dhe ambalazhet e tjera me anë të metodës së shpëlarjes ose metodës së marrjes së mostrës dhe mbjelljen indirekte në mostrën e përgatitur në atë mënyrë;
- ✧ ekzaminimi i pastërtisë bakteriologjike të kozmetikës mjekësore dhe preparateve kozmetike që përdoren nga popullata e përgjithshme, siç janë preparatet për mirëmbajtjen e higjienës personale dhe për zbukurimin e fytyrës dhe trupit;

Për këtë laborator prioritet është edhe modernizimi dhe kompletimi i laboratorëve me pajisje laboratorike, si dhe fillimi i procesit të akreditimit të laboratorit për kontrollin e barnave dhe produkteve kozmetike dhe preparateve për zbatimin e standardit ISO 17025 dhe ISO 15189.

- *Laboratori për testimin e endoksinës bakteriale*

Kjo Njësi në punën e saj e ka implementuar sistemin e cilësisë - MKCENISO 17025:2018.

Analiza të cilat kryhen sipas standardeve dhe metodave në fuqi (Ph.Eur/USP/BP):

- ✧ ekzaminimi i pranisë/mungesës së endotoksinës bakteriale në preparate parenterale për përdorim human, substanca për përdorim farmaceutik, preparate për ujitje me metodën e gel clot;
- ✧ ekzaminimi i pranisë/mungesës së endotoksinës bakteriale në preparate mjekësore (barna parenterale për përdorim human, serume, vaksina, substanca për qëllime farmaceutike, preparate për irigacion, ujë për hemodializë, tretje për hemodializë) sipas specifikimeve

dhe metodave të përshkruara në botimet në fuqi të Farmakopesë Evropiane (Ph.Eur.), Farmakopesë Amerikane (USP), Farmakopesë Britanike (BP) si dhe specifikimeve dhe metodave të vërtetuara të prodhuesit të preparatit final (Ph. Eur. 2.6.14, testi LAL - Metoda e testit Gel Clot, metoda e akredituar sipas MKC EN ISO/IEC 17025:2018);

- ★ laborator i për testimin e endotoksinës bakteriale parashih prezantimin e një testi për endotoksinën bakteriale tek pajisjet mjekësore me teknikën Gel Clot;
- ★ testimi i endotoksinës bakteriale bëhet me kërkesë nga Agjencia për Barna dhe Pajisje Ndihmëse Mjekësore e RMV-së, Institucionet shëndetësore publike me të cilat Instituti ka lidhur marrëveshje, si dhe nga persona juridikë privatë.

Njësia e parazitologjisë

Njësia e parazitologjisë kryen diagnostikim parazitologjik të protozoave dhe helminthëve me rëndësi mjekësore dhe formave të tyre. Si pjesë e aktiviteteve rutinore dhe programore kjo Njësi kryen edhe këto aktivitete.

- ★ vërtetim dhe identifikim të parazitëve në mostra humane;
- ★ vërtetim dhe identifikim të parazitëve në ujë.

Njësia e parazitologjisë bën edhe ekzaminime parazitologjike të cilat sipas rregulloreve ligjore i nënshtrohen mbikëqyrjes shëndetësore:

- ★ të personave që vijnë nga vende ku ka rrezik epidemiologjik nga disa sëmundje ngjitëse të caktuara;
- ★ të personave që punojnë në prodhimin dhe tregtimin e produkteve ushqimore dhe ujit të pijshëm me qëllim të parandalimit të sëmundjeve parazitare - ekzaminime sanitare.

Njësia e parazitologjisë e ndjek rregullshmërinë shëndetësore të ujit të pijshëm, ujërave sipërfaqësore dhe ujërave të zeza, në përputhje me rregulloret ligjore. Sipas kërkesave për akreditim (ISO 17025), Njësia prezanton një sistem filtrimi membranor plotësisht të automatizuar, i projektuar posaçërisht dhe i destinuar për testimin parazitologjik të ujit.

Analiza të cilat kryhen në Njësinë e parazitologjisë:

- ★ feces për cista dhe forma vegetative të protozoave dhe vezë të helminthëve – preparat nativ;
- ★ feces për cista dhe forma vegetative të protozoave dhe vezë të helminthëve – metoda e koncentrimit;
- 33. strisho me cellofan (perianal) për *Enterobius vermicularis*;
- 34. vërtetim i *Trichomonas vaginalis* nga trakti gjenital, uretral, urina, ejakulati, (reaksion zinxhir i polimerazës në kohë reale, preparat nativ, kultivim);
- ★ material bioptik dhe punktate nga organe për parazitë indorë (native, ngjyrosje diferenciale);
- ★ detektimi i parazitëve në lëngjet dhe ekskretet trupore (native, ngjyrosje diferenciale);
- ★ analizë gjaku për mikrofilarie (metoda e Knott);
- 35. detektimi i antigjenit të *Giardia lamblia* (në mënyrë imunokromatografike);
- 36. detektimi i antigjenit të *Cryptosporidium spp.* (në mënyrë imunokromatografike);
- 37. detektimi i antigjenit të *Plasmodium falciparum* (në mënyrë imunokromatografike);

38. detektimi i antigjenit të *Plasmodium vivax*, *Plasmodium ovale*, *Plasmodium malariae* (në mënyrë imunokromatografike);
 - ★ detektimi i antitropave IgM/IgG për mikrofilarie (në mënyrë imunokromatografike);
39. detektimi i antitropave IgM për *Leishmania donovani* (imunofluoreshencë indirekte);
40. detektimi i antitropave IgG për *Leishmania donovani* (imunofluoreshencë indirekte);
41. detektimi i antitropave IgM/IgG për *Leishmania donovani* (në mënyrë imunokromatografike);
42. detektimi i antitropave IgG për *Echinococcus granulosus* (imunofluoreshencë indirekte);
43. detektimi i antitropave IgA për *Echinococcus granulosus* (imunofluoreshencë indirekte);
44. detektimi dhe difencimi i *Echinococcus granulosus* / *Echinococcus multilocularis*;
 - ★ (western blot);
 - ★ detektimi i antitropave *Brucella* spp. (BAB test kualitativ, kuantitativ – hemaglutinim i tërthortë);
45. detektimi i antitropave *Entamoeba histolytica* (kuantitativ – hemaglutinim i tërthortë);
46. detektimi i *Chlamydia trachomatis* nga trakti gjenital – strisho uretrale, nga urina, nga konjuktiva (reaksion zinxhir i polimerazës në kohë reale);
47. detektimi i llojeve të *Plasmodium* në gjak (reaksion zinxhir i polimerazës në kohë reale);
 - ★ përcaktimi makroskopik dhe mikroskopik i helminthëve;
 - ★ përcaktimi makroskopik dhe mikroskopik i artropodeve.



6. DEPARTAMENTI I EKZAMINIMIT DHE KONTROLLIT TË BARNAVE

Udhëheqës: Farm. dipl./spec. Katerina Starkovska

Aktivitete të Departamentit të ekzaminimit dhe kontrollit të barnave:

Departamenti i ekzaminimit dhe kontrollit të barnave me autorizim nga Agjencia e Barnave e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa mbi bazë të “Ligjit për Barnat dhe Pajisjet Mjekësore” („Gazeta Zyrtare e RM-së“ nr. 106/07, 88/10, 36/11, 53/11, 136/11, 11/12, 147/13, 164/13, 27/14, 43/14, 88/15, 154/15, 228/15, 7/16, 53/16, 83/18, 113/18, 245/18” dhe „Gazeta Zyrtare e RMV-së” nr. 28/21) si dhe akteve nënligjore, kryen testim të pavarura, gjegjësisht ekzaminime analitike dhe kontroll të cilësisë së barnave për ta verifikuar përputhjen e tyre me specifkimet e cilësisë të miratuara paraprakisht.

Gjatë testimit analitik ndiqen udhëzimet e botimeve në fuqi të Farmakopesë Evropiane, Farmakopesë Britanike dhe Farmakopesë Amerikane, parimet dhe udhëzimet e Praktikës së Mirë Laboratorike dhe rekomandimet e OBSH-së.

Departamenti i ekzaminimit dhe kontrollit të barnave në mënyrë eksplicite e definojnë misionin, vizionin dhe qëllimet për krijimin e një sistemi të qendrueshëm për kontrollin e cilësisë së barnave. Në kuadër të veprimit të përbashkët me Agjencinë e Barnave, ky Departament i përcakton dhe koordinon edhe prioritetet kombëtare në fushën e sistemit shëndetësor.

Aktivitetet të cilat i zbaton Departamenti i ekzaminimit dhe kontrollit të barnave bëhen me kërkesë të Agjencisë së Barnave dhe Inspektoratit Shtetëror Sanitar dhe Shëndetësor pranë Ministrisë së Shëndetësisë.

Në Departamentin e ekzaminimit dhe kontrollit të barnave përcaktohet edhe rregullshmëria shëndetësore e produkteve kozmetike dhe produkteve për mirëmbajtjen e higjienës në amvisëri dhe industri duke zbatuar Ligjin për Sigurinë e Produkteve Kozmetike G. Zyrtare nr. 55/07 dhe aktet nënligjore: Rregullorja për përmbytjen e detergjenteve që duhet të shënohet në ambalazh, si dhe rregullat e përgjithshme dhe të veçanta të etiketimit në ambalazhin e detergjenteve G. Zyrtare nr. 84/2011, Rregullorja për listën e të dhënave për përmbytjen e detergjenteve G. Zyrtare nr. 84/2011 dhe Urdhri për ndalimin e prodhimit, shitjes dhe përdorimit të detergjenteve për larjen në makinë të produkteve tekstile me përmbytje fosfori në formë organike ose inorganike me mbi 0.5% të peshës, si dhe Rregullorja Evropiane.

Qëllimi i Departamentit është që në treg të qarkullojnë barna, preparate bimore, preparate me origjinë biologjike, produkte kozmetike, produkte për mirëmbajtjen e higjienës dhe të tjera me cilësi të vërtetuar.

Aktivitetet kryhen sipas sistemit të cilësisë, gjegjësisht standardit MKS ISO/IEC 17025:2018 (teknikat e akredituara në Njësinë e ekzaminimeve kimiko-fizike, Njësinë e ekzaminimeve farmaceutike-teknologjike, Njësinë e kozmetologjisë dhe Njësinë e punës për parametrin Endotoksina bakteriale që kryhen në Njësinë e kontrollit mikrobiologjik të ushqimit dhe barnave).

Departamenti i ekzaminimit dhe i kontrollit të barnave është i përbërë nga tre njësi:

- ✧ Njësia e ekzaminimeve fiziko-kimike
- ✧ Njësia e ekzaminimeve farmaceutike-teknologjike
- ✧ Njësia e kozmetologjisë

Dy njësi pune pranë Departamentit të mikrobiologjisë - Njësia e kontrollit mikrobiologjik të ushqimit dhe të barnave kryejnë detyra për Departamentin e ekzaminimit dhe të kontrollit të barnave (pastërtia mikrobiologjike, steriliteti dhe endotoksinat bakteriale).

Njësia e ekzaminimeve fiziko-kimike

Njësia e ekzaminimeve farmaceutike-teknologjike

Në këto Njësi kryhet kontroll fiziko-kimik i cilësisë së barnave, dhe atë:

- ✧ kontroll i rregullt i cilësisë së çdo bari të lëshuar në treg në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të paktën një herë në pesë vjet;
- ✧ kontroll i cilësisë i serisë të parë të barit pas marrjes së lejes për lëshimin e tij në treg;
- ✧ kontrolli i cilësisë me kërkesë të Agjencisë së Barnave gjatë procedurës së marrjes së lejes për lëshimin e barit në treg ose pas dhënies së lejes me kërkesë të organit inspektues;
- ✧ kontroll specifik i cilësisë së kategorive specifike të barnave me kërkesë të Agjencisë së Barnave;
- ✧ identifikim dhe përcaktimi i përmbajtjes së komponentëve aktivë kanabidiol (CBD), (-)-D9-trans-tetrahidrokanabinol (D9-THC) dhe produktit të degradimit kanabinol në ekstraktet e kanabisit mjekësor dhe produktet e gatshme që përmbajnë ekstrakt mjekësor të kanabisit.

Për realizimin e kontrollit laboratorik përdoren teknikat e mëposhtme: kromatografia e lëngshme me efektivitet të lartë (HPLC), kromatografia me gaz (GC), spektroskopia me rreze infra të kuqe (IR), ultravjollcë (UV) dhe spektroskopia e dukshme (Vis), teknikat gravimetrike, teknikat vëllimore, sipas specifikimeve dhe metodave të përshkruara në botimet në fuqi të Farmakopesë Evropiane (Ph.Eur.), Farmakopesë së Shteteve të Bashkuara (USP), Farmakopesë Britanike (BP) dhe specifikimeve dhe metodave të validuara të prodhuesit të produktit final.

Krahas aktiviteteve të lartpërmendura, kryhet edhe vlerësimi profesional i dokumentacionit për kontrollin e cilësisë dhe vlerësimi i paketimit të serive të importuara të barnave biologjike/vaksinave.

Njësia e kozmetologjisë

Në këtë Njësi bëhet testimi i cilësisë dhe rregullshmërisë shëndetësore të produkteve kozmetike në përputhje me Ligjin për Sigurinë e Produkteve Kozmetike G. Zyrtare nr. 55/07, Rregulloren 1223/2009, Listën e produkteve që konsiderohen si produkte kozmetike G. Zyrtare nr. 156/2007; Listën e substancave që kristalizohen gjatë prodhimit të produkteve kozmetike G. Zyrtare nr.89/2010; Listën e konservansëve përdorimi i të cilëve lejohet në produktet kozmetike G. Zyrtare nr.89/2010; Rregulloren për përmbajtjen dhe mënyrën e etiketimit të produkteve kozmetike G. Zyrtare nr.98/2010 Rregulloren për kriteret e pastërtisë mikrobiologjike dhe kimike të produkteve kozmetike dhe metodat e kontrollit të këtyre kriterëve G. Zyrtare nr.94/2010 dhe Rregulloren për lëshimin në treg të gjësedeve për përdorim të përgjithshëm G. Zyrtare 26/83.

Në këtë Njësi konfirmohet përshtatshmëria e specifikimeve për cilësinë dhe qëllimin e synuar të produkteve për ruajtjen e higjienës në amvisëri në përputhje me këto rregullore ligjore: Rregullorja për lëshimin në treg të gjësedeve për përdorim të përgjithshëm G. Zyrtare 26/83; Rregullorja për të dhënat për përmbajtjen e detergjenteve që duhet të shënohen në paketim, si dhe rregullat e përgjithshme dhe të veçanta për etiketimin e paketimit të detergjenteve G. Zyrtare nr. 84/2011; Rregullorja për listën e të dhënave për përmbajtjen e detergjenteve G. Zyrtare nr. 84/2011, Urdhri për ndalimin e prodhimit, shitjes dhe përdorimit të detergjenteve për larjen me makinë të produkteve tekstile me përmbajtje fosfori në formë organike ose inorganike me më shumë se 0.5% të peshës.

Në këtë Njësi kryen analiza me qëllim lëshimin në treg (dhënia e çertifikatës së rregullshmërisë shëndetësore) të produkteve nga grupi i produkteve kozmetike.

Kontrollit i nënshtrohen këto grupe të produkteve:

- ✳ Mjete për higjienë personale;
- ✳ Mjete të dedikuara për higjienë dhe përkujdesje të foshnjave dhe fëmijëve të vegjël;
- ✳ Produkte nga grupi i kozmetikës dekorative;
- ✳ Mjete për higjienë në amvisëri;
- ✳ Produkte për përdorim profesional;
- ✳ Lëndë të para për prodhimin e produkteve kozmetike dhe produkteve nga grupi i mjeteve për mirëmbajtjen e higjienës personale dhe higjienës së amvisërisë.

Gjatë punës në këtë Njësi përdoret aparaturë e sofistikuar, si: 4 sisteme HPLC, GC, spektrometër FTIR, spektrometër UV/VIS, Aparat për lirimin e substancës aktive nga format farmaceutike të dozuara për tretshmërinë, Aparat për dekompozimin, pH metër, AAS - aparat për përcaktimin e metaleve të rënda, Aparat për analizën e endoksinë bakteriale (metoda LAL test – Gel clot) dhe aparate të tjera.

Profillet e punonjësve në këtë Njësi janë multidisiplinare dhe përfshijnë doktor shkencash nga farmacia, farmacistë specialistë të ekzaminimit dhe kontrollit të barnave, mjek specialist i mikrobiologjisë, biolog specialist, doktor të shkencave të kimisë, magjistër të shkencave të kimisë, farmacistë të diplomuar, inxhinierë të diplomuar të kimisë, biologë të diplomuar, dhe kadro profesionale me arsim të mesëm – teknikë të kimisë.



7. DEPARTAMENTI I EKZAMINIMEVE KIMIKE DHE RADIOLOGJIKE

Udhëheqës: Prof. Zorica Arsova Sarafinovska

Aktivitete të Departamentit të ekzaminimeve kimike dhe radiologjike

Paraqet një njësi organizative-teknike e cila bashkon një pjesë të laboratorëve në I.Sh.P. IShP të RMV-së. Segmenti laboratorik i aktiviteteve dhe detyrave të IShP-së të përcaktuara me Ligjin për Shëndetin Publik të RMV-së realizohet plotësisht. Organizimi, detyrat, kompetencat dhe përgjegjësitë e punonjësve rregullohen me Statutin dhe Rregulloren për organizimin dhe sistematizimin e brendshëm të vendeve të punës në I.Sh.P. IShP të RMV-së.

Ekzaminimet laboratorike kryhen në përputhje me standardet dhe rregulloret kombëtare dhe ndërkombëtare në fuqi, me ç'rast bëhet një kujdes i vazhdueshëm për nevojat dhe kërkesat e shfrytëzuesve dhe një rritje e vazhdueshme të nivelit të besueshmërisë së rezultateve.

Cilësia në kryerjen e analizave laboratorike sigurohet nëpërmjet përgatitjes dhe respektimit të standardeve dhe udhëzimeve të harmonizuara profesionale, avancimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve në fushën e shëndetit publik, zbatimit dhe mirëmbajtjes të një sistemi laboratorik për menaxhimin dhe akreditimin e laboratorëve.

Departamenti është i përbërë nga:

1. Njësia e ekzaminimit të cilësisë së ushqimit
2. Njësia e ekzaminimit të ujërave
3. Njësia e ekzaminimit të rregullshmërisë shëndetësore të gjëseneve për përdorim të përgjithshëm
4. Njësia e ndotësve dhe ekotoksikologjisë
5. Njësia e ekzaminimit të metaleve
6. Njësia e mbrojtjes nga rrezatimi

Njësia e ekzaminimit të cilësisë së ushqimit

Laboratori për ekzaminimin e cilësisë së ushqimit është i akredituar në pajtim me standardin ISO 17025 nga viti 2006 për këto metoda:

- ★ Përcaktimi i ujit në produktet ushqimore (0201 UP 7.2.65);
- ★ Përcaktimi i përmbajtjes së hirit në produktet ushqimore (0201 UP 7.2.66);
- ★ Përcaktimi i shkallës së aciditetit dhe aciditetit në vajra dhe yndyra shtazore dhe bimore (ISO 661:2003);
- ★ Përcaktimi i numrit të saponifikimit në vajra dhe yndyra shtazore dhe bimore (ISO 3657:2002);
- ★ Përcaktimi i materieve të pasaponifikueshme në vajra dhe yndyra shtazore dhe bimore (ISO 3596:2000);
- ★ Përcaktimi i aciditetit të titrueshëm në produkte nga frutat dhe perimet (ISO 750:1998);
- ★ Përcaktimi i përmbajtjes së kripës në gjalpë (ISO 1738:2004);
- ★ Përcaktimi i përmbajtjes së yndyrnave në qumësht (ISO 2446:1976, ISO 488:1983);
- ★ Përcaktimi i aciditetit të qumështit (Rregullore për metodat e analizave fizike dhe kimike të qumështit dhe produkteve të qumështit „Fleta Zyrtare” e RSFJ-së, nr.32/83);
- ★ Përcaktimi i materies së thatë në qumësht (Rregullore për metodat e analizave fizike dhe kimike të qumështit dhe produkteve të qumështit „Fleta Zyrtare” e RSFJ-së, nr.32/83);
- ★ Përcaktimi i aciditetit të kosit dhe jogurtit (Rregullore për metodat e analizave fizike dhe kimike të qumështit dhe produkteve të qumështit „Fleta Zyrtare” e RSFJ-së, nr.32/83);
- ★ Përcaktimi i materies së thatë në kos dhe jogurt (Rregullore për metodat e analizave fizike dhe kimike të qumështit dhe produkteve të qumështit „Fleta Zyrtare” e RSFJ-së, nr.32/83);
- ★ Përcaktimi i përmbajtjes së ujit në drithë dhe produkte të drithit (ISO 712:2009);
- ★ Përcaktimi i përmbajtjes së hirit në drithë dhe produkte të drithit (ISO 2171:2007);
- ★ Përcaktimi i sasisë së përgjithshme të hirit në çaj (ISO 1575:1987);
- ★ Përcaktimi i humbjes së masës në çaj (ISO 1573:1980);
- ★ Përcaktimi i sasisë së përgjithshme të acideve, si acidi acetik në uthull (0201 UP 7.2.35);
- ★ Përcaktimi i përmbajtjes së lagështisë në amidon (ISO 1666:1996);
- ★ Përcaktimi i hirit në niseshte (ISO 3593:1981);
- ★ Përcaktimi i përmbajtjes së hirit të patretshëm në acid klorhidrik tek produktet nga frutat dhe perimet (ISO 763:2003);
- ★ Përcaktimi i jodit në kripë (UNICEF/ROSCA, 1989);
- ★ Përcaktimi i konservansëve, benzoat natriumit dhe sorbat kaliumit me HPLC tek pijet joalkoolike (§35 LMBG L 00.00-9, 1984);
- ★ Përcaktimi i ëmbëlsuesve artificialë (sakarinë, aspartam dhe acesulfam -K) tek pijet joalkoolike (§35 LMBG L 00.00, 2001);
- ★ Përcaktimi i përbërja e acideve yndyrore në ushqim me kromatografi me gaz me GC-FID ISO 12966-2;
- ★ Përcaktimi i përmbajtjes së nitrateve në perime dhe produkte nga perimet me metodën HPLC (ISO 12014:2-2018);

- ★ Përcaktimi i glutenit (alergjen) në produktet ushqimore me metodën ELISA (AOAC- OMA (2012.01);
- ★ Përcaktimi i ujit në mish dhe produkte të mishit (ISO 1442:1997);
- ★ Përcaktimi i përmbajtjes së hirit në mish dhe produkte të mishit (ISO 936:1998).

Në Laboratorin për ekzaminimin e cilësisë së ushqimit bëhet kontroll e cilësisë së këtyre grupeve të produkteve ushqimore:

- ★ pijeve alkoolike dhe joalkoolike;
- ★ ëmbëlsirave;
- ★ miellit;
- ★ produkteve nga frutat dhe perimet;
- ★ qumështit dhe produkteve të qumështit;
- ★ mishit dhe përpunimeve të mishit;
- ★ yndyrnave dhe vajrave;
- ★ lëndëve të para dhe aditivëve në industrinë ushqimore;
- ★ erëzave dhe barishteve;
- ★ aromave dhe koncentrateve për pije freskuese;
- ★ ushqimeve për foshnja;
- ★ aditivëve në ushqim.

Testimi i parametrave të cilësisë së produkteve ushqimore bëhet me metoda standarde dhe të përcaktuara sipas Rregulloreve kombëtare në fuqi dhe direktivave të BE-së.

Në mostrat për ekzaminim analizohen parametrat e mëposhtëm: përmbajtja e ujit, materia e thatë, hiri, proteinat, yndyrat, sheqernat, fibrat dietike, përmbajtja e acideve organike, alkooli, sasia e përgjithshme e ekstraktit, dendësia relative, numri i saponifikimit, numri i jodit, shkalla e acidit, etj.

Në bazë të parametrave kimikë të ekzaminuar përcaktohet edhe vlera energjetike e produkteve ushqimore.

Përveç kësaj në produktet ushqimore ekzaminohet edhe prania e aditivëve të ndryshëm si: konservues (benzoate, sorbate), ëmbëlsues (acesulfame, aspartam, saharinë), ngjyra ushqimore artificiale, ngjyra sudan.

Përmbajtja e vitaminave (hidro dhe liposolubile) përcaktohet në suplementet ushqimore, në të cilat analizohet prania e disa përbërësve aktivë si: koenzima Q10, hespiridina, diosmina, izoflavonet, kuercetina, xhinsenozidet, acidi kinik, glukozamina, kondroitina etj.

Njësia e ekzaminimit të ujërave

Në kuadër të Njesisë së ekzaminimit të ujërave kryhen ekzaminime të llojeve të ndryshme të ujërave, si:

- ★ uji për pije;
- ★ uji mineral natyral;

- ★ uji i burimeve;
- ★ uji i ambalazhuar (uji për pije dhe uji mineral natyral);
- ★ uji teknik dhe tekniko-teknologjik;
- ★ uji për lartje rekreative;
- ★ uji sipërfaqësor.

Kjo Njësi është e akredituar në përputhje me standardin ISO 17025:2018 për këto metoda:


- ★ Përcaktimi fotometrik i ngjyrës (ISO 7887:2013);
- ★ Përcaktimi i sasisë së përgjithshme të mbetjeve të thata të tretura në 105°C, 180°C dhe 260°C (“Voda za pice – Standardne metode za ispitivanje higijenske ispravnosti” S. Škunca-Milovanović, R. Fe- liks, B. Đurović, Beograd 1990);
- ★ Përcaktimi i pH (MKC ISO 10523:2013);
- ★ Përcaktimi i përçueshmërisë elektrike (ISO 7888:1985);
- ★ Përcaktimi i indeksit të permanganatit (Konsumi i KMnO₄) (ISO 8467:1993);
- ★ Përcaktimi i klorideve sipas Mohr (ISO 9297:1989);
- ★ Përcaktimi i përmbajtjes së kalciumit –metoda titrimetrike EDTA (ISO 6058:1984);
- ★ Përcaktimi i përmbajtjes së magnezit (ISO 6059:1984);
- ★ Përcaktimi i sasisë së kalciumit dhe magneziumit –metoda titrimetrike EDTA (ISO 6059:1984);
- ★ Përcaktimi i alkalinitetit (total-m, përbërës-p dhe alkaliniteti karbonat) (ISO 9963) (m-alkalinitet, p- alkalinitet, karbonate, bikarbonate, hidrokside).

Në pajtim me Rregulloret për llojet e ndryshme të ujërave kjo Njësi bën analiza themelore dhe periodike, në të cilat bëjnë pjesë këto ekzaminime:

- ★ Përcaktimi i anioneve me kromatografi jonike (fluoride, kloride, nitrite, bromide, nitrate, fosfate dhe sulfate);
- ★ Përcaktimi i katjoneve me kromatografi jonike (litium, natrium, kalium, amonium, magnez dhe kalcium);
- ★ Përcaktimi i metaleve të rënda (hekur, mangan, bakër, zink, plumb, kadmium, kobalt, nikel dhe krom);
- ★ Përcaktim i turbullirës.

Njësia e ekzaminimit të rregullshmërisë shëndetësore të gjëseneve për përdorim të përgjithshëm

Njësia e ekzaminimit të rregullshmërisë shëndetësore të gjëseneve për përdorim të përgjithshëm ka një rëndësi të madhe, sepse është njësi e vetme e akredituar e këtij lloji në RMV.



Në këtë njësi bëhet ekzaminimi i rregullshmërisë shëndetësore të:

- ★ materialeve dhe produkteve që vijnë në kontakt me produktet ushqimore, të cilat duhet të plotësojnë kushte të përgjithshme dhe të veçanta që të mos ndikojnë në cilësinë dhe sigurinë e ushqimit dhe të mos e rrezikojnë shëndetin e konsumatorëve;
- ★ ekzaminimi i rregullshmërisë shëndetësore të materialeve dhe produkteve që vijnë në kontakt me lëkurën dhe mukozën;
- ★ si dhe ekzaminimi i rregullshmërisë shëndetësore i lodrave për fëmijë.

Ekzaminimet kryhen në përputhje me legjislacionin kombëtar ekzistues, i cili u referohet objekteve për përdorim të përgjithshëm dhe lodrave për fëmijë, si dhe Rregulloreve dhe Direktivave më të fundit të BE-së.

Parametrat të cilat testohen për lloje të veçanta të gjësendeve:

- ★ migrimi i plotë i substancave të pa avullueshme;
- ★ migrimi specifik i metaleve (Pb, Cd, Cr, Ni, Mn, Co, Zn, Fe, Cu);
- ★ migrimi specifik i shumës së amineve aromatike primare;
- ★ lëshimi i ngjyrës në tretjen e testimit, dhe
- ★ testimi i vetive mekanike dhe fizike të lodrave për fëmijë.

Në këtë Njësi bëhen testime në pajtim me këtë ndarje të gjësendeve për përdorim të përgjithshëm (të importuara ose prodhim vendor):

- ★ enë dhe pajisje për produkte ushqimore (nga qelqi, qeramika, druri, letra, metali, smalti);
- ★ ambalazh për produkte ushqimore;
- ★ lodra për fëmijë;
- ★ mjete për higjienë personale;
- ★ mjete për higjienë në amvisëri;
- ★ enë për fëmijë të vegjël dhe foshnja;
- ★ granulate plasmasi;
- ★ pjesë të makinave, dhe
- ★ ambalazh.

Njësia e ekzaminimit të rregullshmërisë shëndetësore të gjësendeve për përdorim të përgjithshëm është e akredituar në pajtim me standardin ISO/IEC 17025 për këto metoda:

- ★ Përcaktimi i metaleve në gjësendet nga qeramika sipas 84/500/EEC dhe Gazeta Zyrtare e RM-së nr.1/2013 (20130010005);
- ★ Përcaktimi i shumës së amineve aromatike primare në gjësendet e prodhuara nga plastika”, në pajti me "Amtliche Sammlung von Untersuchungsverfahren nach§35 LMBG (Lebensmittel- und Bedarfsgegen ständegesetz)" L00.00-6 dhe
- ★ Përcaktimi i metaleve të rënda në lodrat për fëmijë nga materiale të ndryshme sipas EH 71-3:2019.

Njësia e ndotësve dhe ekotoksikologjisë

Në Njësinë e ndotësve dhe ekotoksikologjisë bëhet ekzaminimi i përmbajtjes së mbetjeve të pesticideve në këto produkte ushqimore: perime, fruta, drithëra dhe produkte të drithërave, vajra ushqimorë, ujë të pijshëm, ujë të ambalazhuar, ujë sipërfaqësor dhe të tjera. Pesticidet që përdoren për eliminimin e keqbërësve të ndryshëm dhe për përmirësimin e rendimentit dhe mbrojtjen e bimëve duhet të testohen me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës dhe në pajtim me rregulloren për pesticidet G. Zyrtare nr. 95/2021, ku janë definuar kufijtë maksimal të lejuar që tolerohen nëse pesticidet aplikohen sipas praktikës së mirë të prodhimit.

Në këtë Njësi ekzaminohet edhe prania e mykotoksinave, të cilat janë produkte sekondare të metabolizmit të myshqeve. Sipas Rregullores në fuqi për ndotësit

G. Zyrtare nr. 227/2021 është i domosdoshëm kontrollimi i pranisë së mykotoksinave në drithëra dhe produkte të drithërave, produkte arnore, fruta të thata, kafe dhe produkte të tjera. Në këtë Njësi bëhet edhe ekzaminimi i pranisë së mykotoksinave në lulet e thata të kanabisit në pajtim me farmakopenë evropiane dhe është laborator i parë i akredituar për këtë lloj analize. Të gjitha analizat kryhen si obligim rutinor, ligjor, me kërkesë të klientit apo shërbime inspektuese të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë.

Njësia është e pajisur me kromatografë të gaztë me detektim të masës (MS), detektorë FTD dhe ECD dhe pajisje ndihmëse që përdoren për përcaktimin e mbetjeve të pesticideve të mëposhtme:

- ★ phorate, terbufos, diazinon, chlorpyrifos-methyl, pirimiphos-methyl, malathion, fenthion, pendimethalin, buprofezin, ethion, benalaxyl, iprodione, bifenthrin, tebufenpyrad, azinphos-methyl, phosalone, azinphos-ethyl, boscalid, ethoprophos, methyl parathion, fenitrothion, malathion, parathion, fenamifos, phosmet, HCB (Hexachlorbenzene), trifluralin, alpha HCH, beta HCH, Lindane - gamma HCH, delta HCH, heptachlor, aldrin, dieldrin, endrin, 2,4'-DDE, 4,4'-DDE, 2,4'-DDD, 2,4'-DDT, 4,4'-DDD, 4,4'-DDT, alpha Endosulfan, beta Endosulfan, Endosulfan sulfat, alpha chlordane, imazalil, alpha Cypermetrin, acetamiprid, metoxichlor, deltametrin në produktet ushqimore, ujë dhe lule të kanabisit.

Përcaktimi i mykotoksinave bëhet në mënyrë fluorimetrike dhe me metodën ELISA në këto produkte:

- ★ Numri i përgjithshëm i aflatoksinave (B1+B2+G1+G2) në fruta arnore (kikirikë, bajame, fara kajsie, fëstëkë, lajthi dhe arra indie), drithëra dhe misër, kanabis, fruta arnore, erëza, birra, vaj;
- ★ Ochratoxin A në kanabis, kafe jeshile, drithëra, misër, erëza, birra dhe verë;
- ★ Deoxynivalenol në drithëra, misër dhe birra;
- ★ Zearalenone në drithëra, misër dhe birra;
- ★ Fumonisin në drithëra dhe misër.

Nga viti 2018 Njësia e ndotësve dhe e ekotoksikologjisë është akredituar në pajtim me standardin ISO 17025 për këto metoda:

- ✳ Përcaktimi i mbetjeve të pesticideve në fruta dhe perime me Kromatrograf të gaztë me detektor për masën (GC-MS);
- ✳ Përcaktimi i pesticideve në ujë me Kromatrograf të gaztë me detektor për masën (GC-MS);
- ✳ Procedura fluorimetrike për përcaktimin e numrit të përgjithshëm të aflatoksinave në kikirikë, produkte nga kikirikët, bajame, fara kajsie, fëstëkë, lajthi dhe arra indie (Metoda VICAM AflaTest);
- ✳ Procedura fluorimetrike për përcaktimin e numrit të përgjithshëm të aflatoksinave në drithëra dhe misër (Metoda VICAM AflaTest);
- ✳ Procedura fluorimetrike për përcaktimin e numrit të përgjithshëm të aflatoksinave në lulen e kanabisit (Metoda VICAM AflaTest).

Njësia e ekzaminimit të metaleve

Sipas Programit Kombëtar për mbrotje shëndetësore preventive (pjesa sanitaro-shëndetësore), në këtë Njësi bëhet ekzaminimi e përmbajtjes së metaleve toksike në produktet ushqimore, ekzaminimi i përbërjes minerale të ushqimit me veti të veçanta ushqyese, përcaktimi i një pjese të metaleve toksike (As, Al, Hg, Ni) në ujëra, lule të kanabisit, barna dhe preparate kozmetike. Të gjitha këto detyra kryhen si pjesë e detyrave rutinore, detyrimeve ligjore, me kërkesë të shfrytëzuesit të shërbimeve ose sipas indikacioneve.

Si pjesë e aktiviteteve të projektit në këtë Njësi kryen edhe analiza të metaleve toksike në material biologjik.

Njësia kryen edhe monitorim të rregullt të përmbajtjes së metaleve të rënda tek produktet ushqimore të disponueshme në rrjetin më të gjerë tregtar. Dy herë në vjet bëhet edhe ekzaminimi i metaleve të rënda tek perimet dhe frutat e stinës të disponueshme në tregjet e gjelbërta ekzistuese. Këto aktivitete monitoruese organizohen nga ISHP-Shkup, Ministria e Shëndetësisë e RMV-së dhe Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë e RMV-së.

Njësia e ekzaminimit të metaleve është e akredituar nga viti 2006, në pajtim me standardin ISO 17025 dhe me sukses i mban akreditimet për të gjitha metodat.

Kjo Njësi disponon me këto pajisje analitike:

- ✳ Microwave digestion system ETHOS UP;
- ✳ ICP MS;
- ✳ GFAAS;
- ✳ FAAS;
- ✳ Mercury Analyses system FIMS 100.

Ekipi profesional përfshin specialistë të kimisë sanitare, magjistër të kimisë, inxhinier teknolog të diplomuar, laboratorant mjekësor të specializuar për laborator kimiko-biokimik.

Njësia e mbrojtjes nga rrezatimi

Njësia e mbrojtjes nga rrezatimi kompetencën e tij e bazon në këto ligje: Ligjin për Mbrojtje Shëndetësore, Ligjin për Shëndetin Publik dhe Ligjin për Mbrojtjen nga Rrezatimi Jonizues dhe Siguria nga Rrezatimi.

Nga këto ligje burojnë detyrimet dhe detyrat e Institucionit të Shëndetit Publik të RMV-së, Nësia e e mbrojtjes nga rrezatimi, në pjesëmarrjen në mbrojtjen e popullatës nga pasojat e dëmshme të rrezatimit jonizues.

Për realizimin e detyrave që burojnë nga ligjet përkatëse për mbrojtjen nga rrezatimi jonizues, kjo Njësi përbëhet nga tri seksione, dhe atë:

Seksioni i dozimetrisë i cili bën:

- ★ dozimetri personale e personave të cilët gjatë punës janë të ekspozuar ndaj rrezatimit jonizues;
- ★ vlerësim të rrezikut nga ekspozimi radioaktiv në vendin e punës me burime të rrezatimit jonizues dhe material radioaktiv;
- ★ vlerësim të shkallës së ekspozimit ndaj rrezatimit të popullatës dhe punonjësve në vendin e punës;
- ★ kontroll të cilësisë së aparateve të rentgenit në diagnostikën mjekësore dhe veterinare;
- ★ trajnim për personat e interesuar për mbrojtje nga rrezatimi dhe për siguri, dhe
- ★ matje dozimetrike në vendkalimet kufitare si masë për parandalimin e transportit të materialeve radioaktiv edhe nukleare në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Seksioni i kalibrimit i cili bën:

- ★ kalibrim të instrumenteve/dozimetrave për monitorim ambiental dhe personal që përdoren gjatë mbrojtjes nga rrezatimi në mjekësi dhe industri.

Seksioni i radioekologjisë i cili:

- ★ me ndihmën e metodave analitike bën detektimin dhe kuantifikimin e përmbajtjeve të radionukleideve naturogjene dhe antropogjene në mostra të ndryshme (ushqim, ujë, ajër, materiale ndërtimore, etj);
- ★ bën monitorim të vazhdueshëm aktiv dhe pasiv në mjedisin jetësor të radionukleideve naturogjene Radon (Rn222) dhe Toron (Rn220) me theks të veçantë në shkollat në RMV-së, dhe
- ★ bën monitorim të vazhdueshëm të rrezatimit gama të ambientit të jashtëm në territorin e RMV-së.

Për përmbushjen e detyrave të përcaktuara në këtë mënyrë kjo Njësi është e pajisur me kuadër profesional të lartë, profesionalizmi i të cilit avancohet vazhdimisht nëpërmjet pjesëmarrjeve aktive në trajnime shtesë, kurse trajnimi, seminare në fushat e interesit si brenda ashtu dhe jashtë vendit, e që kryesisht i organizon Agjencia Ndërkombëtare për Energjinë Atomike në Vjenë (IAEA).

Sa i përket anës teknike dhe teknologjike Njësia është e pajisur në mënyrë adekuate me pajisje moderne karakteristikat e të cilave i plotësojnë parametrat e vendosur nga standardet teknike në fuqi.

Kompetencat e larta profesionale të Njesisë në fushën e mbrojtjes nga rrezatimi jonizues konfirmohen nga fakti që laboratorit është anëtar i barabartë i:

- ★ Rrjetit Botëror të Laboratorëve të Dozimetrisë Standarde Sekondare (LDSS) të Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike dhe Organizatës Botërore të Shëndetësisë;
- ★ Grupacionit Evropian të Laboratorëve dozimetrik – EURADOS;

- ★ Rrjetit Evropian për Monitorim të Vazhdueshëm të Rrezatimit Jonizues në Mjedisin e Jashtëm – EURDEP dhe
- ★ Rrjetit të Laboratorëve Dozimetric të Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike – ALMERA.

Njësia bashkëpunon me disa institucione dhe organizata ndërkombëtare duke marrë pjesë aktive në aktivitetet e tyre, si:

- ★ zbatimi, koordinimi ose pjesëmarrja e ekspertëve tanë në projektet e Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike në Vjenë, IAEA, Vienna;
- ★ bashkëpunimi me Qendrën për Hulumtime pranë Komisionit Evropian, JRC Center, Ispra, Italy;
- ★ anëtarësimi në grupin e ekspertëve të NATO-s, Bruksel, etj.

Përmes bashkëpunimit me Agjencinë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike (MAAE) laboratorit ka zbatuar një numër projektesh për avancim tekniko-teknologjik, si dhe për përsosje të mëtutjeshme profesionale të punonjësve, dhe atë:

- ★ Projekt për vendosjen e një sistemi modern të dozimetrisë personale me vënie në përdorim të dozimetrave personale termolumineshente (DTL) si zëvendësim të sistemit të vjetër me dozimetra filmike, avancimin e tij me prezantimin e një sistemi plotësisht të automatizuar për leximin e dozimetrave personale, nëpërmjet projekteve: MAK/9/002, MAK/9/003 MAK/6/020;
- ★ Projekt për ndërtimin e një laboratorit të kalibrimit për kalibrimin e instrumenteve/dozimetrave për mbrotje nga rrezatimi, si dhe avancimin e tij shtesë për kalibrimin e instrumenteve që përdoren në kontrollin diagnostik të cilësisë, nëpërmjet projekteve: MAK/1/002 dhe MAK/6/012;
- ★ Projekt për krijimin e aftësive për regjistrimin e vazhdueshëm e të qëndrueshëm të rrezatimit të jashtëm gama me përmirësimin përkatës të sistemit për marrjen e mostrave, monitorimin dhe kontrollin e ndotësve në mjedisin jetësor, duke përfshirë këtu Radonin (Rn222) dhe Toronin (Rn220), si dhe një projekt të ri, i cili është në zhvillim e sipër dhe që synon rritjen e aftësive teknike për monitorim në mjedisin jetësor, nëpërmjet projekteve: MAK /7/002 dhe MAK7/003.

Numri më i madh i metodave me të cilat Laboratori kryen testimet/kalibrimet janë të akredituara në bazë të standardit të kompetencës ISO17025, duke filluar nga standardi ISO17025/2006 dhe më pas me riakreditim deri në ISO17025/2018.

Bazuar në këtë standard dhe nëpërmjet standardeve teknike përkatëse, laboratorit i ka akredituar metodat e mëposhtme, dhe atë:

Seksioni i dozimetrisë:

- ★ vlerësimi i ekuivalentit të dozës personale nga ekspozimi i jashtëm ndaj rrezatimit jonizues me dozimetra termolumineshente për monitorim personal ose monitorimin e mjedisit jetësor;
 - Hp(10) dhe Hp(0.07)
 - Me standardet teknike: IEC 62387:2012
 - dhe IAEA GSG-7:2018

Seksioni i kalibrimit:

- ✧ dozimetra standarde në fushën e mbrojtjes nga rrezatimi për madhësinë Kerma në ajër K_{aj} , për rrezatimin gama dhe rreze të rentgenit;
- ✧ dozimetra në fushën e mbrojtjes nga rrezatimi për madhësinë Ekuivalent i dozës ambientale $H^*(10)$ për rrezatimin gama dhe rreze të rentgenit;
- ✧ dozimetra aktivë në fushën e mbrojtjes nga rrezatimi për monitorim personal për madhësitë Ekuivalent i dozës personale $H_p(10)$ dhe $H_p(0,07)$ për rrezatimin gama dhe rreze të rentgenit;
- ✧ rrezatimi i dozimetrave pasivë në fushën e mbrojtjes nga rrezatimi për monitorim personal për madhësitë Ekuivalent i dozës personale $H_p(10)$ dhe $H_p(0,07)$ për rrezatimin gama dhe rreze të rentgenit;
- ✧ me Standardet teknike: ISO 4037/I/II/III/2019(E) dhe ISO29661/2017.

Seksioni i radioekologjisë:

- ✧ Matja e radioaktivitetit në mjedisin jetësor - Tokë - Pjesa e tretë: Metoda për testimin e radionuklideve që emitojnë gama rreze me gama-spektrometri.
Me standardin teknik: ISO18589-3:2015;
- ✧ Cilësia e ujit - Përcaktimi i përqendrimit të aktivitetit të radionuklideve - Metoda e gama spektrometrisë me rezolucion të lartë/
Me standardin teknik: ISO 10703:2021;
- ✧ Cilësia e ujit - Matja e aktivitetit të përgjithshëm alfa në ujë të ëmbël – Metoda e burimit të trashë
Me standardin teknik: MKC ISO 9696:2018;
- ✧ Cilësia e ujit - Matja e aktivitetit të përgjithshëm beta në ujë të ëmbël – Metoda e burimit të trashë
Me standardin teknik: MKC EN ISO 9697:2019.



8. SEKTORI I PUNËVE ADMINISTRATIVE DHE I LOGJISTIKËS

Udhëheqës: Ek. dipl. Julijana Tomanovska

Aktivitete të Sektorit të punëve administrative dhe logjistikës:

- ★ përgatitja dhe formulimi juridik i draft verzioneve për të gjithë aktet e brendshme dhe të përgjithshme të Institutit;
- ★ përpunimi dhe formulimi juridik i të gjithë vendimeve, aktvendimeve dhe konkluzioneve të organeve udhëheqëse të Institutit;
- ★ ndjekja dhe zbatimi i dispozitave ligjore me rëndësi të përgjithshme dhe dhënia e mendimeve juridike në lidhje me implementimin e duhur të dispozitave ligjore dhe të tjera;
- ★ përpilimi i dispozitave të brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale dhe dokumentacionit mbi masat teknike dhe organizative për sigurimin e fshehtësisë dhe mbrojtjen e përpunimit të të dhënave personale dhe harmonizimi i dispozitave të brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale dhe dokumentacionit për masat teknike dhe organizative për sigurimin e fshehtësisë dhe mbrojtjen e të dhënave personale, me ligjin dhe dispozitat e miratuara në bazë të Ligjit për Përpunimin e të Dhënave Personale;
- ★ pjesëmarrja në zhvillimin e masave dhe sjelljen e vendimeve lidhur me përpunimin e të dhënave personale;
- ★ kryerja e të gjitha punëve administrative dhe juridike në Institut;
- ★ realizimi i të gjitha punëve administrative në lidhje me zbatimin e procedurës për përcaktimin e shkeljeve të detyrave të punës dhe përgjegjësisë materiale të të punësuarve në Institut;
- ★ kryerja e të gjitha punëve që rrjedhin nga marrëdhënia e punës;
- ★ kujdesi për realizimin e të drejtave të punëtorëve në lidhje me mbrojtjen shëndetësore dhe sigurimin social;
- ★ planifika afatmesëm i resurseve të nevojshme dhe përpilim të planeve vjetore për punësim, në pajtim me prioritetet dhe politikat e përcaktuara për punësim në Klinikën Universitare;
- ★ realizimi i procedurave për punësim, avancim dhe ndjekje të mobilitetit vertikal dhe horizontal të të punësuarve;

- ★ mbajtja e evidencës personale dhe menaxhimi me të dhënat personale të të punësuarve;
- ★ përpilimi i vendimeve, aktvendimeve, kontratave, marrëveshjeve lidhur me rregullimin e të drejtave dhe obligimeve të të punësuarve konform dispozitave Ligjore dhe nënligjore dhe marrëveshjes kolektive;
- ★ udhëheqja e Sistemit Elektronik për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore SEMBNj;
- ★ vlerësimi i nevojave për trajnim dhe përsosje profesionale të punonjësve shëndetësorë të punësuar me licencë dhe pa licencë; njësive gjenerike dhe specifike tematike dhe përpilimi i planit vjetor për përsosje profesionale të nëpunësve administrativë dhe dhënësve të shërbimeve publike;
- ★ zbatimi i procedurës për vlerësimin e nëpunësve administrativë dhe dhënësve të shërbimeve publike;
- ★ zbatimi i hulumtimeve dhe analizave për kënaqësi në punë, përkushtim të të punësuarve dhe aspekte dhe parametra të tjerë të menaxhimit me burimet njerëzore që ndikojnë mbi produktivitetin ose janë pjesë të akreditimit të entit shëndetësor dhe menaxhimit të cilësisë (ISO, CAF);
- ★ kryerja e punëve nga fusha e mbrojtjes popullore dhe mbrojtjes civile në pajtim me dispozitat ligjore dhe aktet e përgjithshme të Institutit për këtë fushë;
- ★ parashtrimi i padive për kërkesat e paarkëtuara të Institutit dhe konteste të tjera gjyqësore;
- ★ përgatitja teknike për seancat e organeve udhëheqëse gjegjësisht kryerja e të gjitha punëve administrative për këto organe;
- ★ kujdesi për shfrytëzimin adekuat (të dedikuar) të hapësirave të punës;
- ★ udhëheqja e arkivit të Institutit sipas dispozitave për punën në zyrë, pranimit, hapja, regjistrimi, rradhitja, shpërndarja dhe dërgimi i postës;
- ★ regjistrimi dhe arkivimi i akteve, gjegjësisht kujdesi për arkivin administrativ të Institutit;
- ★ kujdesi për mbajtjen e pastërtisë në hapësirat e punës në Institut, për funksionim të duhur të centralit telefonik, shërbimit zjarrfikës, për sigurimin e ndërtesave dhe pronave të Institutit, si dhe për zbatimin e rendit shtëpiak të Institutit;
- ★ projektimi, instalimi, mirëmbajtja dhe zhvillimi i sistemit informatik;
- ★ realizimi i punëve të tjera për nevojat e Institutit që janë të lidhura me sistemin dhe teknologjinë informatike;
- ★ organizimi dhe përshtatja me njësitë e tjera punuese punën në lidhje me përdorimin e automjeteve, transportin e materialeve dhe punëtorëve për udhëtime zyrtare me mjetet transportuese të Institutit, gjegjësisht përlogaritja dhe kontrolli i përdorimit të mjeteve të transportit dhe shpenzimit të lëndëve djegëse (karburanteve) dhe vajit;
- ★ kujdesi për mirëmbajtjen dhe sanimin e objektit, objekteve ndihmëse të Institutit, mjediseve të punës, instalimeve, aparateve dhe pajisjeve dhe mjeteve të tjera themelore dhe inventarit me angazhim vetanak ose nëpërmjet personave të tretë;
- ★ analiza dhe përpilimi i Planit për llojin dhe vëllimin e shërbimeve me të cilin sigurohen mjete nga FSSHM-ja për funksionimin e Institutit;
- ★ përpilimi i Raporteve me kërkesë të FSSHM-së dhe Ministrisë së Shëndetësisë;
- ★ kryerja e përditshme të punëve të arkës dhe trezorit;
- ★ pranimi dhe kontrolli i qarkullimit ditor dhe dorëzimi i të njëjtit në bankë;
- ★ kontrolli i rregullshmërisë së faturave që paguhen nëpërmjet trezorit të FSSHM-së;

- ★ realizimi i të gjitha llojeve të pagesave nëpërmjet trezorit të FSSHM-së;
- ★ ngarkimi i planeve financiare si dhe konvertimi i tyre në trezorin e FSSHM-së;
- ★ ndjekja e realizimit të kompenzimit sipas marrëveshjes/planit financiar;
- ★ përgatitja e rrogave dhe pagesës së tyre të të punësuarit;
- ★ lëshimi i vërtetimeve për lartësinë e rrogës neto për nevojat e të punësuarve dhe
- ★ realizimi i punëve të tjera nga fusha e qarkullimit pagesor;
- ★ punë nga fusha e kontabilitetit, punëve materiale dhe financiare;
- ★ përpilimi i faturave mujore për shërbimet e kryera ndaj FSSHM-së si dhe përpilimi i faturave ndaj të gjithë subjekteve të tjerë që shfrytëzojnë shërbimet e Institutit;
- ★ evidentimi i kërkesave dhe arkëtimi i tyre, si dhe evidentimi i obligimeve dhe pagesës së tyre;
- ★ mbajtja e evidencës për materialet dhe inventarin e imët dhe shpenzimin e tyre;
- ★ ndjekja e realizimit të të hyrave dhe shpenzimeve;
- ★ përgatitja, pranimi, likuidimi dhe kontrolli i dokumenteve kontabiliste;
- ★ përpilimi i llogarive periodike dhe përfundimtare;
- ★ përpilimi i raporteve të ndryshme financiare në varësi të kërkesave;
- ★ evidentimi kontabilist imjeteve themelore të subjektit;
- ★ përlllogaritja e amortizimit dhe revalorizimit;
- ★ harmonizimi i mjeteve dhe burimeve të mjeteve në gjendjen kontabiliste me atë reale;
- ★ organizimi i inventarizimit (regjistrimit) vjetor të materialeve, inventarit të imët dhe mjeteve themelore dhe akordimi i gjendjes kontabiliste me gjendjen reale;
- ★ asistencë profesionale në përpilimin e përlllogaritjeve të të hyrave dhe shpenzimeve;
- ★ ndjekja dhe zbatimi i dispozitave ligjore nga fusha e punëve kontabiliste, materiale dhe financiare;
- ★ punë të tjera nga fusha e kontabilitetit;
- ★ koordinimi i përgatitjes së Planit për prokurime publike që duhet të jetë i harmonizuar me Planin financiar të miratuar nga ana e FSSHM-së;
- ★ përgatitja dhe përpilimi i dokumentacioneve tenderuese në koordinim me personat kompetentë nëpër departamente dhe sektorë;
- ★ përgatitja e akteve të nevojshme nga fillimi i procedurës dhe në bazë të raportit nga procedura e realizuar konform Ligjit për prokurime publike (Vendime për prokurime publike, vendime për përzgjedhjen e ofertuesit më të volitshëm, njoftime për përzgjedhje deri te operatorët ekonomikë, përpilimin e kontratave për prokurime publike dhe dokumente të tjera të nevojshme);
- ★ sigurimi i ndihmës dhe koordinimit për Komisionin për prokurime publike;
- ★ azhurnimi i dokumenteve të nevojshme në Sistemin elektronik për prokurime publike të Byrosë për prokurime publike;
- ★ përgatitja e porosive dhe ndjekja e shfrytëzimit konform marrëveshjeve për prokurime publike;
- ★ pjesëmarrja në përgatitjen e buxhetit; në përpilimin e planit për prokurime publike; dhe kujdesi për zbatimin e planit për prokurime publike;

- ★ ndjekja e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve publike dhe është përgjegjës për zbatimin e drejtë të tyre;
- ★ ndjekja e lidhjes së marrëveshjeve dhe realizimit të tyre në bazë të Ligjit për Prokurime Publike;
- ★ pjesëmarrja si anëtar komisioni të procedurat për lidhjen e kontratës për prokurim publik me vlerë të përcaktuar prej mbi 130.000 euro në kundërvlerë denarësh për mallra dhe shërbime dhe mbi 5.000.000 euro në kundërvlerë denarësh për punime;
- ★ përgatitja e akteve të nevojshme në bazë të raportit nga procedura e zbatuar;
- ★ publikimi i referencave negative në SEPP;
- ★ dhënia e direktivave dhe udhëzimeve për organin kontraktues në lidhje me veprimet në procedurë ankimore në bashkëpunim me komisionin;
- ★ kujdesesi për dosjet nga procedurat e zbatuara konform dispozitave për punën arkivore dhe punën në zyrë.

Në sektorin e punëve administrative dhe logjistikës janë të përfshira edhe kompetencat me karakter ndihmës-teknik që i realizojnë personat ndihmës-teknik të punësuar në Institut:

- ★ mirëmbajtje teknike e pajisjeve;
- ★ sigurim i objektit;
- ★ pastrim dhe mirëmbajtje e higjienës në objekt;
- ★ punë të tjera.

Në përbërje të këtij Sektori bëjnë pjesë këto Njësi:

- ★ Njësia e veprimtarisë juridike- normative dhe e bashkëpunimit ndërkombëtar
- ★ Njësia e punëve të kontabilitetit dhe të financave
- ★ Njësia furnizimeve publike
- ★ Njësia e punëve komerciale dhe e arkëtimit të borxheve
- ★ Njësia e burimeve njerëzore, e marrëdhënieve me publikun dhe e logjistikës

NJË PJESË E AKTIVITETEVE TË PROJEKTEVE

Emri i projektit	Donatori, organizata, etj.	Periudha/Viti i zbatimit
ESPAD 2019	EMCDDA	2018/2019
Aplikacioni Bebbo	UNICEF	2022
Hulumtim online për drogar në RMV	EMCDDA	2021/2022
Strategjia për prindërim	UNICEF,MSH	2022
Mbikëqyrja dhe reagimi ndaj gripit të shpendëve dhe gripit pandemik nga autoritetet shëndetësore kombëtare jashtë SHBA-ve	CDC nëpërmjet WHO dhe SECID	2017/2021
PRO-METROFOOD	EU	2017
INHERIT	EU	2016
HMB4EU	EU	2020
Equal life	EU	2020
Bihevirol study – COVID-19	WHO	2021
Hulumtim i njohurive, qëndrimeve dhe praktikave (KAP) në lidhje me vaksinimin kundër gripit në mesin e punonjësve shëndetësorë në Republikën e Maqedonisë së Veriut	RKI në bashkëpunim me SECID	2019
Mbështetje teknike dhe operacionale për ngritjen e Njësisë operative të emergjencav të MSh-së dhe RMV-së në kuadër të krijimit të Qendrave Operative të Emergjencave në Shëndetin Publik	WHO	2020
Implementimi i PHEOC në Maqedoni	WHO, RKI	2020/2021/2022
Studim për hulumtimin sero-epidemiologjik mbi infeksionin me virusin COVID-19 në mesin e popullatës së përgjithshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të radhitur sipas moshës	WHO	2021/2022
Ndërtimi i kapaciteteve për ndjekje epidemiologjike të rasteve me COVID-19 dhe kontakteve të tyre dhe komunikimi për COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut	WHO, RKI	2021
Hulumtim për hartëzimin e kapaciteteve të “zinxhirit të ftohtë” për ruajtjen dhe transportin e vaksinave që përdoren në Republikën e Maqedonisë së Veriut	PIVI (Partnership for Influenza Vaccine Introduction)	2019
Qëndrimet e prindërve për imunizimin kundër morbililit –studim KAP	WHO	2019/2020
Operacionalizimi i PHEOC dhe rretëzimi me njësitë rajonale dhe lokale të EOC në Maqedoni	WHO	2022
Studimi për efektivitetin e vaksinës kundër COVID-19 tek pacientët me SARI	WHO	2022
MAK 5009	IAEA (Agjencia Ndërkombëtare për Energjinë Atomike)	2021-2022
Nisma Evropiane për ndjekjen e obezitetit tek fëmijët (COSI)	M3 dhe C30	2010, 2013, 2016, 2019, 2022

